

Prof.Dr.Hfz.

Hajredin Hoxha



MEDITIMI I KUR'ANIT FISNIK

-edukata dhe parimet-



Doc.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

MEDITIMI I KUR'ANIT FISNIK
-edukata dhe parimet-

Përktheu:

Sedat ISLAMI

Recesent:Mr.Sci.Islam Hasani

Redaktor: Ilmi Rexhepi

Dr. Hajredin HOXHA

MEDITIMI I KUR'ANIT FISNIK

-edukata dhe parimet-

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.

Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij librit në tërësi pa lejen paraprake me shkrim të Autorit.

PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:
Sedat ISLAMI

Titulli në origjinal:
Dr. Hajruddin Huxheh,

*El-Adab err-rruhijje ve-l-mebadi el-imanijeh litedebburil-l-Kur'ani-l-Kerim
-kiraetun fi xhuhudi ba'di el-kudama ve-l-muasirine*

Dr. Hajredin HOXHA

MEDITIMI I KUR'ANIT FISNIK

-edukata dhe parimet-

Përmbajtja:

PARATHËNIE

Rëndësia e punimit

Shkaku i hulumtimit

Metodologjia e punimit

Risia e këtij punimi

Skema e punimit

HYRJE

1. PËRCAKTIMI TERMINOLOGJIK

1.1 Domethënia gjuhësore dhe terminologjike e fjalës 'meditim'

I. POZITA E KUR'ANIT FISNIK NË JETËN E NJERËZVE

1. RAPORTET E NJERËZVE ME KUR'ANIN FAMËLARTË

2. OBLIGIMI YNË KARSHI KUR'ANIT DHE NEVOJA E ZEMRËS PËR
MEDITIM DHE KOMENT

3. RAPORTET E PEJGAMBERIT [alejhis salatu ves selam] DHE SELEFIT
ME KUR'ANIN FISNIK

II. SHKËNDIJA NGA THËNIET E KOMENTUESVE RRETH VLERËS DHE MIRËSISË SË MEDITIMIT TË KUR'ANIT FISNIK

1. KOMENTUESIT KLASIKË

1.1. Imam Zemahsheri

1.2. Fahrudin Rraziu

1.3. Imam Kurtubiu

2. KOMENTUESIT BASHKËKOHORË

2.1. Sejjid Kutbi

2.2. Tahir ibni Ashuri

2.3. Shejh Shenkiti

III. NEVOJA E SJELLJES NDËRMEND TË MORALIT DHE TE ETIKËS GJATË MEDITIMIT

1. ETIKA SHPIRTËRORE DHE PSIKIKE E MEDITIMIT

2. ETIKA SHPIRTËRORE DHE PARIMET MORALE SIPAS IMAM GAZALIUT

PËRFUNDIM

Bibliografia

PARATHËNIE

Falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar, i Cili në Librin e Tij madhështor thotë:

بِالْبَيِّنَاتِ وَالزُّبُرِ وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ ﴿٤٤﴾

(I patëm dërguar) Me argumente e me libra të shenjtë. Ty ta zbritëm Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë (Kur'anin)." (en-Nahl, 44)

Pastaj në një ajet tjetër Allahu xh.sh thotë:

كَتَبْنَا أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٩﴾

(Ky është) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend." (Sad, 29)

Ndërsa përshëndetjet qofshin për zotërinë e njerëzimit, Muhammedin, profetin e dërguar me Libër të Madh, libër që ndan të vërtetën nga e kota dhe bindjen nga dyshimi. Përshëndetjet, po kështu, qofshin edhe për familjen e tij, shokët dhe të gjithë ata që ecin rrugës së tij deri në amshim!

Sot, në këtë kohë të vështirë, bisedat për sukses, lumturi, mirëqenie, janë pothuajse më të shpeshtat. Madje, edhe librat dhe ligjëratat me këtë tematikë janë bukur shumë sa kohë që çdonjëri pretendon se mënyra, koncepti ose programi i tij janë zgjidhja më e duhur.

Këto janë pretendimet e tyre, ndërsa çështja, në realitet, është krejtësisht ndryshe. Rrugëdalja nga kjo gjendje është vetëm nëpërmjet Kur'anit dhe Sunnetit, duke i mësuar, studiuar dhe më pas praktikuar ashtu siç janë në origjinal. Reformimi i këtij Ummeti dhe suksesi i tij janë të varura për asaj me të cilën janë reformuar të parët dhe kanë arritur sukses me të.

Rëndësia e punimit

Koha në të cilën jetojmë është ndoshta etapa më e errët e Ummetit Islam përgjatë gjithë historisë së tij. Ummeti është nënshtruar, bijtë e tij kanë ngelur mbrapa në shkencë dhe dije, armiqtë i janë vërsulur nga çdo anë

ndërsa shqyejnë thesarin e tij duke garuar se kush do të marrë më shumë prej tij, në ndërkohë që myslimanët këtë e perceptojnë si kulturë dhe prej tyre ka që ftojnë në përvetësimin e kulturës perëndimore si kulturë të veten.¹

Përfytyrimi i imazhit islam në sytë e perëndimorëve është i zbehur, i mjegullt, i paqartë, armiqësor, edhe pse në fakt janë perëndimorët ata që janë armiqësorë. Këtë e dëshmon më së miri fakti i luftërave të shumta kundër myslimanëve në Irak, Afganistan, Pakistan, Çeçeni, Ballkan (Bosnjë dhe Kosovë), Palestinë, që perëndimi dhe shtete joislame i ndërmorën kundër tyre. Ka qenë dashur që botëkuptimet e tyre për Islamin të jenë më të matura, të jenë nga këndvështrimi real dhe rrjedhimisht të jenë objektive. Është vërtetuar se bota perëndimore (duke futur këtu të gjitha shtetet joislame), në fakt banorët e jo qeveritë dhe institucionet, kanë shumë pak njohuri për gjeografinë, historinë, fenë dhe çështjet e botës islame. Ata janë viktima të studimeve orientalistike, si tash si në të kaluarën, sikur që janë viktima edhe të medie dhe mjeteve të informimit sionist. Lindori dhe myslimani për ta janë njerëz të vrazhdë, të pasjellshëm, robër epshesh...Kanë bindjen se nuk ka ndonjë interes a dobi në njohjen me gjendjen dhe rrethanat e këtyre popujve të prapambetur, siç i quajnë zakonisht. Lindja, për ta, është vatër magjie, besëtytnish, dobësish, çerdhe djajsh dhe fallxhorësh...Nëse ka zhvillim teknologjik, atëherë kjo, thonë, është në saje të zhvillimit perëndimor. Lindori në sytë e tyre është gjakatar, terrorist, fundamentalist, ekstremist...

Shkak i këtyre opinionëve dhe perceptimeve të shëmtuara për lindjen (botën islame) sigurisht se janë luftërat e kryqëzatave, roli dekonstruktiv i medie, qëndrimi orientalist i devijuar qëllimshëm, etj. Kështu, bazuar në këtë që thamë, për të përmirësuar imazhin e shtrembëruar dhe për të larguar atë një ideologjike që kanë ata, vjen ky punim si një përpjekje për të ofruar imazhin e vërtetë, dhe para së gjithash, për të ftuar ata që t'i kthehen Kur'anit Fisnik, respektivisht ta meditojnë atë dhe faktet e tij duke qenë, paraprakisht, të çliruar nga urrejtja dhe qëllimet e këqija. Kjo, për arsye se Kur'ani është libri i të gjitha kohëve dhe i tërë njerëzimit, dhe se mesazhi i tij u dedikohet të gjithë atyre pa përjashtim. Sa mirë do të ishte sikur t'i kthehen Kur'anit për ta studiuar e, rrjedhimisht, për ta kursyer atë nga shpifjet dhe akuzat, si ndaj tij si ndaj Pejgamberit Muhammed [*alejhis salatu ves selam*]! Sa mirë do të bëhej sikur ta lexonin ngadalë dhe qetë, të thelloheshin në kuptimet dhe në domethëniet e tij, të meditonin

¹ Bekkar, Abdul Kerim, *Asruna vel ajshu fi zamanihi-s-sa'b*, f.5-25.

dimensionet e dispozitave dhe urdhëresave fetare, e kështu të hynin grupe-grupe në Islam! ²

Shkaku i hulumtimit

Ideja për këtë hulumtim ka ardhur si rezultat i disa shkaqeve:

- 1) Neglizhimi i meditimit të Kur'anit
- 2) Keqinterpretimi i mësimëve të Kur'ait nga muslimanët ose të tjerët
- 3) Demotivimi i njerëzve për ta studiuar, kuptuar, nxënë përmendësh si dhe praktikuar Kur'anin
- 4) Shfaqja e rrymave devijante në komentimin e Kur'anit
- 5) Trendet e reja politike, ideore dhe fetare
- 6) Sulmet e pareshtura të armiqve të Islamit
- 7) Marrja e njerëzve me çështje dhe temat të rrezikshme, si: tekfiri (apostazia- shpallja e njerëzve renegatë), tefsiku (gjykimi si të dalë nga tradita fetare), tebdii (shpallja e njerëzve si risimtarë, novatorë) si dhe komentimi me forma devijante i Kur'anit
- 8) Marrja e një grupi njerëzish me hulumtime filozofike shterpe

Këto dhe shkaqe tjera më shtynë që të ndaja kohë të bëja një punim të veçantë rreth nevojës së njerëzve në përgjithësi dhe të hoxhallarëve në veçanti që t'i kthehen meditimit të Kur'anit sipas formës së duhur dhe të qëlluar.

Metodologjia e punimit

Metodologjia që kam ndjekur në këtë punim është tredimensionale: induktive, deskriptive si dhe kritike.

Risia e këtij punimi

Risi në këtë punim është hulumtim dhe mbledhja e thënieve të dijetarëve në të shkuarën dhe të tanishmen përkitazi me edukatën, etikën dhe mënyrën e meditimit të Kur'anit. Kam mbledhur thëniet, kam analizuar ato, kam bërë një radhitje tematike, i kam verifikuar, për t'i sjellë më pas në një formë të re, më të lehtë për t'u kuptuar dhe për t'u praktikuar. Në fakt, ato i kam ndarë sipas tematikës në dy kapituj kryesorë:

- 1) Edukata dhe morali përkitazi me të medituarit

² Për këtë, nëse do më shumë, shih video në: www.turntoislam.com

- 2) Bazat shkencore dhe rregullat metodike përkitazi me komentimin (tefsirin, ekzegjezën)

Këtë ndarje kësisoj nuk e kam hasur tek autorët klasikë dhe as tek këta bashkëkohor.

Në këtë punim, në fokus do ta kam etikën dhe moralin e meditimit.

Skema e punimit

Punimin e kam ndarë në:

- 1) *Parathënie*, ku kam shpjeguar shkaqet e përzgjedhjes së këtij punimi, rëndësinë e tij, metodologjinë time në të si dhe risinë që sjell ky punim.
- 2) *Hyrje*, ku kam bërë shpjegime terminologjike.
- 3) *Tre kapituj*, në të parin prej të cilëve kam folur për pozitën e Kur'anit tek njerëzit, raportet e tyre me të, që në një farë forme paraqet edhe një lloj diagnostifikimi të sëmundjes, obligimet tona karshi Kur'anit dhe nevojën shpirtërore për meditim si kurim i sëmundjes së përmendur. *Kapitullin e dytë* ua kam dedikuar thënieve të dijetarëve klasikë dhe bashkëkohorë, ndërsa në *kapitullin e tretë* jam fokusuar kryesisht në etikën e meditimit, ku, kam bërë një përmbledhje të disa parimeve etike dhe morale për të përmendur më pas edhe qasjen e Imam Gazaliut për etikën në fjalë.

- 4) Dhe përfundimin bashkë me bibliografinë e veprave të konsultuara.

Me këtë rast, e ndiej si obligim moral, që të shpreh falënderimet e mia të sinqerta dhe respektin tim të madh për dy kolegët e mi, Prof. Dr. Seid Muhammed Ismail Savin dhe Prof. R. Mekki Aklajinehun, që të dy profesorë në UNISSA, Brunei Darussalam, për këshillat, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre shkencore, metodologjike dhe gjuhësore.

I falënderoj shumë dhe e lus Allahun e Madhëruar që t'i shpërblejë me të mirat e Tij në këtë dhe në botën tjetër!

HYRJE

1. PËRCAKTIMI TERMINOLOGJIK

1.1 Domethënia gjuhësore dhe terminologjike e fjalës ‘meditim’ (ar. *Tedebbur* - التدبير)

Fjala ‘*tedebbur*’ në gjuhën arabe ka kuptimin e shikimit në fundin (rezultatet) e gjërave dhe të meditimit në to. Thuhet: ‘*Tedebburu-l-kelam*’ – shikim dhe diskutim rreth fillimit dhe mbarimit të atij të foluri, e pastaj rishikim herë pas here. Për këtë shkak ka ardhur në formën ‘*tefeuul*’, sikur fjalët ‘*texherr-rruë, tefehum, tebejjun*’, dhe është e derivuar nga shikimi në përfundimin e gjërave dhe në fundin e tyre³.

Ndërsa në terminologji, ‘*Tedebuur-i*’ (meditimi) nënkupton: ‘*Të kuptuarit e domethënieve të shprehjeve kur’anore dhe të medituarit në aludimet e ajetit, edhe nëse teksti sipërfaqësisht nuk i përfshin ato aludime apo domethënie.*’⁴

Bazuar në këtë, domethënia e ‘meditimit të Kur’anit’ na del:

“Thellimi i lexuesit në meditimin dhe në përsiatjen rreth ajeteve kur’anore për të parë se në fund çfar ‘mësimesh, këshillash dhe urtësish mund të përfitohen prej tyre, për të ngopur kështu kureshtjen, për ta zhytur thellë mendjen e tij në koncepte si dhe për t’u udhëzuar drejt një sjellje dhe kulturë sipas mësimëve hyjnore.”

Meditimi po kështu përfshin edhe njohjen e domethënieve të shprehjeve dhe frazave të përafërta, njohjen e kontekstit të ajetit, atë që fitohet nga konteksti, atë që fitohet nga pjesët paraprake ose pasuese dhe lidhshmërinë tematike ndërmjet tyre. Këto botëkuptime kanë rëndësinë e tyre të madhe për mendjen dhe shpirtin e besimtarit. Imami Ibnul Kajjimi thotë:

“..Kjo quhet meditim, rikujtim, vështrim, rishikim, nxjerrje mësim, thellim i shikimit. Këto janë domethënie të përafërta, që bashkohen në diç, e ndahen në diç tjetër. Quhet meditim (tefekkur), për shkak se nënkupton të angazhosh mendimin tënd me rastin e mendimit. Është rikujtim (tedhekkur) për shkak se nënkupton ta

³ Ibn Mendhur; Muhammed ibn Mukrim in Mendhur el-Ifrikijj el-Misrijj, *Lisanul arab*, 4/27; Kurtubi, Ebu Abdullah Muhammed ibn Ahmed el-Ensari, *El-xhamiu li ahkamil Kur’an*, 5/290; Esfehani; el-Husejn in Muhammed ibn el-Mufeddal, *Mufredat elfadhil Kur’an*, etj.

⁴ Ibn Kethir; Ebul Fida Ismail el-Kureshijj ed-Dimeshkijj, *Tefsiru-l-Kur’ani-l-adhim*, 1/501; Neveviu, Jahja ibn Sheref, *Et-tibjan fi arabi hameletil Kur’an*, 2-5.

risjellësh në mendje diturinë për të cilën duhet të kujdesesh për të pasi që më parë mund të kesh qenë neglizhent ndaj saj. Me këtë kuptim ka ardhur ajeti:

إِنَّ الَّذِينَ اتَّقَوْا إِذَا مَسَّهُمْ طَٰئِفٌ مِّنَ الشَّيْطٰنِ تَذَكَّرُوا فَإِذَا هُمْ مُبْصِرُونَ ﴿١١١﴾

Vërtet, ata që janë të ruajtur, kur i prek ndonjë iluzion nga djalli, ata kujtojnë (All-llahun), dhe atëherë shohin (të vërtetën).“ (el-A’rafë, 201)

Quhet vështrim (nadr), ngase nënkupton që të kthehesh me zemër kah gjëja, në të cilin shikohet – vështrohet. Quhet rishikim (te-emma) ngase nënkupton që vështrimin t’i kthehesh here pas here, derisa domethënia e vërtetë t’i shfaqet zemrës së tij. Quhet nxjerrje mësim (i’tibar) nga infinitivi el-ubuur që ka kuptimin e ‘kalimit, kapërcimit’, ngase me të kalohet nga një gjendje në tjetrën. Kalimi bëhet nga ajo në të cilën ke medituar në një informatë – dije të tretë, e që është qëllimi i marrjes mësim –i’tibarit. Për këtë shkak edhe quhet ibretun (këshillë, mësim). Ajo, gjuhësisht, ka ardhur sikur format (xhilsetun, rikbetun) për të treguar se tashmë dija e përfituar është bërë një lloj gjendjeje shoqëruese e njeriut nëpërmjet të cilës shpreh qëllimin e tij. Allahu i Madhëruar thotë:

إِنَّ فِي ذٰلِكَ لَعِبْرَةً لِّمَن يَخْشَىٰ ﴿٢٦﴾

Në këtë ndëshkim ka përvojë mësimi për atë që frikësohet.“ (en-Naziat, 26)

قَدْ كَانَ لَكُمْ آيَةٌ فِي فِئَتَيْنِ الْتَقَتَا ۗ فِئَةٌ تُقَاتِلُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَأُخْرَىٰ كَافِرَةٌ يَرَوْنَهُم مِّثْلَهُمْ رَأْيَ الْعَيْنِ ۗ وَاللَّهُ يُؤَيِّدُ بِنَصْرِهِ ۗ مَن يَشَاءُ ۗ إِنَّ فِي ذٰلِكَ لَعِبْرَةً لِّأُولِي الْأَبْصَارِ



Ju (jehudi) patët një përvojë të madhe në ato dy grupe që u konfrontuat ndërmjet vete. Njëri grup luftonte në rrugën e All-llahut, e tjetri ishte pabesimtar, dhe me shikimin e syve të tyre i shihnin se ishin dy herë më shumë se besimtarët. Po, All-llahu me ndihmën e vet përforcon atë që do. Vërtet, në këtë është një përvojë e madhe për ata që kanë mendje të kthjellët.“ (Ali Imran, 13)

Ndërsa quhet thellim i shikimit (tedebbur) ngase nënkupton shikimin në fundin e gjërave. Nga këtu edhe thuhet tedebbur kavl – fundi (përfundimi, meditimi) i fjalës...“⁵

Konsideroj se është shumë me vend që këtu të përmendim dhe një mendim të Imam Taberiu se meditimi nuk mund të realizohet pa kuptuar paraprakisht Kur’anin, ngase, siç thonë arabët, ‘ai që nuk ka, nuk ka çka të japë.’ Imam Taberiu thotë: Allahu Madhëruar nxit robërit e Tij të marrin mësim nga ajetet kur’anore, respektivisht nga këshillat dhe argumentet, si në ajetin në të cilin i drejtohet të Dërguarit të Tij:

كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبْرَكٌ لِيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿١٧٠﴾

(Ky është) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.“ (Sad, 29)

Poashtu Allahu xh.sh në ajetin tjetër thotë:

وَلَقَدْ ضَرَبْنَا لِلنَّاسِ فِي هَذَا الْقُرْآنِ مِنْ كُلِّ مَثَلٍ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ ﴿١٧١﴾ قُرْآنًا عَرَبِيًّا غَيْرَ ذِي عِوَجٍ لَعَلَّهُمْ يَتَّقُونَ ﴿١٧٢﴾

Ne u kemi sjellë njerëzve në këtë Kur'an shembuj nga çdo lëmi e nevojshme, ashtu që ata të marrin përvojë (mësim), 28. Duke qenë Kur'ani arabisht që nuk ka kundërthënie, me qëllim që të ruhen prej rrugës së gabuar.“ (ez-Zumer, 27-28)

Në këto dhe ajete të ngjashme, Allahu urdhëron dhe nxit robërit e Tij që të marrin mësim na shembujt e ajeteve kur’anore dhe të këshillohen nga këshillat e tyre, gjë që (tërthorazi) aludon në nevojën e të kuptuarit të domethënies që nuk i kanë të qarta nga Kur’ani, ngase nuk është logjike t’i thuhet atij që nuk kupton: Merr mësim nga ajo që nuk kupton... Nuk ka mundësi të meditojë ai që nuk kupton... Kjo i ngjan t’i recitosh vargje arabe atyre që nuk e dinë arabishten e pastaj t’u thuash: merrni mësim nga shembujt dhe këshillat e këtyre vargjeve...Po kështu, mësimet, këshillat dhe shembujt kur’anorë nuk duhet t’u ofrohen atyre që nuk kuptojnë

⁵ , Ibnul Kajjim, *Miftahu Dari-s-seadeh*, 1/182.

Kur'anin, madje as që dinë gjuhën arabe, e t'u thuhet merrni mësim prej tyre..⁶

Meditimi, në rast të përmbushjes së kushteve, nuk është e drejtë vetëm e dijetarëve, por edhe e të gjithë myslimanëve. Në fakt, prej saj nuk përjashtohen as jomyslimanët. Meditimi është sistem që përfshin të gjithë njerëzit e mençur, sikur që është sistem relative, në kuptimin se njerëzit dallojnë në raport me të sipas angazhimit dhe përpjekjes së tyre për të zbuluar domethëniet dhe botëkuptimet e ajeteve kur'anore.

⁶ Taberi, Ebu Xhafer Muhammed Ibn Xherir, *Xhamiul bejani an te'vili ajil Kur'ani*, 1/36-37; 'Tajjar, Musaid ibn Sulejman, *Mefhum et tefsir vet te'vil vel istinbat vet tedebbur vel mufessir*, 104-122.

I. POZITA E KUR'ANIT FISNIK NË JETËN E NJERËZVE

1. RAPORTET E NJERËZVE ME KUR'ANIN FAMËLARTË

Dijetarët, si në të kaluarën, si tani, diskutojnë për shkaqet pse një grup i besimtarëve qëndrojnë indiferentë ndaj Kur'anit dhe mësimëve të tij. Vërtet, sikur të meditonim sado pak për gjendjen tonë, do të mund të vërenim se sa dallim të madh ka ndërmjet asaj se si jemi dhe si duhet të ishim në raport me Kur'anin. Në mesin tonë gjen njerëz të profileve të ndryshme me forma të ndryshme të neglizhimit të Kur'anit: përtaci në leximin e tij, përtaci në nxënien e tij përmendësh, shkujdesje ndaj meditimit të tij, mosveprim sipas porosive të tij, braktisje të thirrjes në të, mos respekti dhe vlerësimi i duhur, etj. Imami Ibnul Kajjimi ka thënë [*Allahu e mëshiroftë!*]: Njerëzit janë tre lloje: *Njeri*, zemra e të cilit ka vdekur. Ky është njeriu që nuk ka zemër. Ajeti nuk është rikujtim për këtë njeri. *I dyti* është njeriu me zemër të gjallë, të përgatitur, por që nuk dëgjon ajetet e lexuara, të cilat flasin për faktet e dëshmuara. Zemra e këtij është e zënë me diç tjetër. Ai ka zemër jo të pranishme. Edhe këtij nuk i mundësohet rikujtimi (nga faktet) me gjithë përgatitjen dhe praninë e zemrës së tij. *I treti* është njeriu që ka zemër të gjallë, të përgatitur, e cila ajetet që i janë lexuar, i ka dëgjuar me vëmendje, me vetëdije, me zemër të pranishme. Ai nuk e ka preokupuar zemrën e tij me diç që do ta privonte nga të kuptuarit. Ky është njeriu që merr mësim nga ajetet e lexuara dhe faktet e dëshmuara. Sa i përket njeriut *të parë*, ai është sikur i verbri që nuk sheh. *I dyti* është sikur personi që me shikimin e tij largohet nga gjëja në të cilën shikohet. Pra, këta, asnjëri, nuk e shohin. Ndërsa *i treti* është personi që sheh dhe që ka ngulur sytë në atë që shikon dhe e pason me shikimin e tij... Ky është ai që e sheh.

I Madhëruar qoftë Ai që fjalët e Tij i bëri shërim për gjokset!

Dije se njeriu mund ta ketë zemrën energjike, përplot me mësim të nxjerra dhe dispozita të përfituara. Këtë zemra e shtyn në marrje mësim dhe rikujtim. Kur t'i dëgjojë ajetet, ato janë dritë mbi dritë për të. këta janë njerëzit më të përsosur, me moralin dhe vetëdijen më të përkryer. Për ta ajo që i ka informuar për të i Dërguari i Allahut [*alejhis salatu ves selam*] është sikur të shihet...Pronari i këtyre lloj zemrash kur t'i dëgjojë ajetet,

atëherë në zemrën e tij ndizet një shkëndijë dije-udhëzimi, me të cilën i shtohet dritë mbi dritë. Por, nëse robi nuk ka këtë lloj zemre vetëm se përkushtohet për dëgjim dhe vëmendje, atëherë edhe ai mund të bëhet nga at që rikujtojnë – marrin mësim nga ajetet...⁷

E, ajo që të bën të ndihesh edhe më keq, është se sot sheh shumë studentë dhe studente tek kalojnë kohën në gjëra të kota, si në leximin e gazetave dhe të revistave, shikimin e telenovelave latine e turke, ndjekjen e ndeshjeve futbollistike, dëgjimin e muzikës, bisedat në rrjete sociale, shikimin e videove në portale t ndryshme, dhënien pas leximit të lajmeve nga jeta e artistëve dhe këngëtarëve, etj, në kohën kur nuk mund të gjesh vetëm se pak prej tyre që i kanë kushtuar Kur'anit një kohë të veçantë. Për pasojë, sheh se ndonëse studentë, ende nuk dinë të shqiptojnë fjalët kur'anore si duhet. Ende nuk kuptojnë as domethëniet esenciale. Këta janë të kundërtit e atyre që kur u lexohen ajetet, marrin mësim.

لَرَأَيْتَهُمْ خَدِشًا مُّتَصَدِّعًا مِّنْ خَشْيَةِ اللَّهِ^ع

...do ta shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga All-llahu...“ (el-Hashr, 21)

Zemrat tona nuk zbuten dhe sytë tanë nuk lotojnë.

ثُمَّ قَسَتْ قُلُوبُكُمْ مِّنْ بَعْدِ ذَلِكَ فَهِيَ كَالْحِجَارَةِ أَوْ أَشَدُّ قَسْوَةً^ع وَإِنَّ مِنَ الْحِجَارَةِ لَمَا يَتَفَجَّرُ

مِنْهُ الْأَنْهَارُ^ع وَإِنَّ مِنْهَا لَمَا يَشَّقُّ فَيَخْرُجُ مِنْهُ الْمَاءُ^ع وَإِنَّ مِنْهَا لَمَا يَهْبِطُ مِنْ خَشْيَةِ اللَّهِ^ع وَمَا اللَّهُ

بِغَفْلٍ^ع عَمَّا تَعْمَلُونَ ﴿٧٤﴾

Edhe pas (fakteve të qarta) zemrat tuaja u bënë pasandej të forta si guri, e edhe më të forta, sepse ka nga gurët prej të cilëve gufojnë lumenj, e ka disa prej tyre që çahen dhe prej tyre buron ujë, madje ka prej tyre që nga frika

⁷ Ibn el-Kajjim; Muhammad ibn Ebu Bekr ibn Ejjub ibn Xheuzijeh Ebu Abdullah, *el-Fevaid*, 10-45.

ndaj Zotit rrokullisen tatëpjetë (nga maja e kodrës). All-llahu nuk është i pakujdesshëm ndaj asaj që veproni ju.” (el-Bekare, 74)

Ndonjëherë i lexojmë ajetet prej të cilave merren mësim të mëdha, ndërsa ne as nuk e vërejmë se i kemi lexuar ato. Sikur ato nuk kanë të bëjnë fare me ne. Pashë Zotin, më thuaj se çfarë kuptimi kanë këto fjalë: “Samed”; “gasikin idha vekab”; “el-hannas”; “vel-lejli idha as’as”?

Këto ajete i lexojmë më shumë se një herë gjatë ditës, por megjithatë nuk i kuptojmë. Çfarë braktisje e madhe e Kur’anit!

Në Kur’an kemi ajete të cilat qortojnë ashpër dhe diskretidojnë ata që ia kthejnë shpinën Kur’anit apo e mohojnë. Thotë Allahu xh.sh.:

وَإِذَا تُلِيٰ عَلَيْهِ آيَاتُنَا وَلِيٰ مُسْتَكْبِرًا كَانَ لَمْ يَسْمَعْهَا كَأَنَّ فِيٓ أُذُنَيْهِ وَقْرًا فَبَشَّرَهُ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿٧٤﴾

E kur i lexohen atij ajetet Tona, ai kthehet kryelartë dhe bëhet sikur nuk i ka dëgjuar ato, bëhet sikur në veshët e tij ka shurdhim të rëndë, pra, ti përgëzoje atë me një dënim të dhembshëm.” (Llukman, 7)

Përsëri në ajetin tjetër Allahu thotë:

وَمِنْهُمْ مَّن يَسْتَمِعُ إِلَيْكَ ۗ وَجَعَلْنَا عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ أَكِنَّةً أَنْ يَفْقَهُوهُ وَفِيٓ آذَانِهِمْ وَقْرًا ۗ وَإِنْ يَرَوْا كُلَّ آيَةٍ لَا يُؤْمِنُوا بِهَا ۗ حَتَّىٰ إِذَا جَاءُوكَ يُتَّبِعُونَكَ يَقُولُ الَّذِينَ كَفَرُوا إِنْ هَذَا إِلَّا أَسْطِيرٌ الْأُولِينَ ﴿٧٥﴾

Ka prej tyre që ty të dëgjonë (kur lexon Kur'anin). Po Ne kemi krijuar mbulesë mbi zemrat e tyre që të mos e kuptojnë atë dhe në veshët e tyre sajuam shurdhim, dhe edhe sikur t'i shohin të gjitha faktet, ata nuk besojnë, derisa kur vijnë te ti e të polemizojnë, ata që mohuan thonë: "Nuk është tjetër ky (Kur'ani) vetëm se mit i hershëm.” (el-En’amë, 25)

وَقَالَ الرَّسُولُ يَرْبِّ إِنَّ قَوْمِي اتَّخَذُوا هَذَا الْقُرْآنَ مَهْجُورًا ﴿٧٦﴾

E i dërguari tha: "O Zot im, vërtet populli im e konsideroi këtë Kur'an si (diç) të hedhur!" (el-Furkan, 30)

Përsëri në ajetin tjetër Allahu xh.sh. thotë:

أَوَلَمْ يَتَفَكَّرُوا مَا بِصَاحِبِهِمْ مِّنْ جِنَّةٍ إِنْ هُوَ إِلَّا نَذِيرٌ مُّبِينٌ ﴿٣٤﴾

A nuk menduan ata se ai, bashkëkohaniku i tyre (Muhammedi), nuk ka farë çmendurie, ai është vetëm qortues i hapët." (el-A'rafë, 184)

Nga kjo që përmendëm, mund të përfundojmë se braktisja e Kur'anit mund të manifestohet në forma dhe imazhe të ndryshme, si:

- 1) Braktisja e leximit, dëgjimit dhe vëmendjes ndaj tij.
- 2) Braktisja duke e zëvendësuar dëgjimin e tij me dëgjimin e fjalëve të kota, këngës, etj.
- 3) Braktisja e veprimit sipas tij si dhe mos përfillja e lejimeve dhe ndalesave.
- 4) Braktisja e të gjykuarit sipas tij.
- 5) Braktisja e kërkimit të shërimit shpirtëror dhe fizik prej tij⁸.
- 6) Braktisja e thirrjes në të dhe përkthimin e tij në gjuhë tjera.
- 7) Braktisja e prezantimit të ligjeve, mësimave dhe porosive të tij në mjetet bashkëkohore të komunikimit.

Disa nga lexuesit e sotshëm janë bërë prej atyre që e lexojnë Kur'anin, ndërsa Kur'ani e mallkon atë. Kjo për shkak se ai e lexon Kur'anin ndërsa nuk ndalet së shari, fyeri, akuzuari, shpifuri, gënjyeri, bëri hipokrizi, kështu që bëhet nga ata që lejohet të mallkohen.

Ndërsa ata që e lartësojnë këtë Kur'an, Allahu ka për t'i lartësuar ata. Është mirësi dhe dhunti e Zotit tonë për lexuesin e Librit të Tij. Ibni Mes'udi ka thënë (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*): "Ithtarët e Kur'anit duhet të njihen me

⁸ Ibid, 156.

*namaz, kur njerëzit flenë, me të qarë, kur njerëzit qeshin, me agjërim, kur njerëzit hanë!"*⁹

Thënies së Ibni Mes'udit do të mund t'ia shtonim edhe këto:

- 1) Ithtarët e Kur'anit duhet të njihen me sinqeritet, kur të tjerët gënjejnë.
- 2) Me besë dhe amanet kur të tjerët tradhtojnë.
- 3) Me bujari dhe dorëdhënie kur të tjerë bëjnë koprraci.
- 4) Me zell dhe angazhim kur njerëzit shfaqin dembeli dhe flenë.
- 5) Me buzëqeshje dhe dashuri kur njerëzit shfaqen të mërrolur dhe arrogantë.
- 6) Me falje, kur njerëzit hakmerren.
- 7) M durim dhe butësi, kur njerëzit tregohen injorantë.
- 8) Me edukatë dialogu kur njerëzit polemizojnë.
- 9) Me largim nga ndejat e pista kur njerëzit në to shkojnë.
- 10) Me largim nga spiunimi, përgojimi, bartja e fjalëve, kur njerëzit në to bien.
- 11) Me përkushtim, sakrificë dhe nder për vendet ku punojnë.
- 12) Me përkujdesje për pamjen e tyre të jashtme kur njerëzit të jenë bërë asketë.

Zoti e di më së miri!

⁹ Ibid, 192; .Neveviu, Jahja ibn Sheref, *Et-tibjan fi arabi hameletil Kur'an*, 44; Shih edhe punimin e autorit me titull: *El-bu'du et-terbeviij fi fikri-l-Imami-n-Neveviij min hilal kitabihi Et-tibjan fi abadil hamleti-l-Kur'an*. Metabiu-rr-rreshid. Medine. 2009.

2. OLIGIMI YNË KARSHI KUR'ANIT DHE NEVOJA E ZEMRËS PËR MEDITIM DHE KOMENT (SHËRIMI)

Obligimet tona karshi Kur'anit janë të shumta. Atë duhet ta trajtojmë me nderin dhe respektin që meriton, qoftë duke e mësuar përmendësh, lexuar, dëgjuar, studiuar, medituar, kuptuar, shpjeguar apo edhe thirrur për të dhe për gjykimin sipas tij. Obligimet tona karshi Kur'anit do të mund t'i përfshinin në pikat vijuese:

- 1) Besimi në të sipas mënyrës së Ehli Sunnetit dhe Xhematit se 'Ai është Fjala e Allahut të Madhëruar, që i është shpallur zotërisë dhe pejgamberit tonë, Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], i përcjellë tek ne sipas mënyrës më të saktë (tevaturo), me leximin e të cilit adhurojmë, ai është sfidues me një citat apo një kaptinë, është ai që ekziston brenda dy kopertinave të Mus'hafit, Allahu ka folur me të si të folur ndërsa ia ka zbritur të Dërguarit të Tij si shpallje - vahj.
- 2) Dhënia e pozitës së merituar duke patur parasysh së është 'të folur të Allahut' dhe kësisoj, respekti ndaj tij, është respekt edhe për Allahun, dhe madhërimi i tij, është madhërim edhe për Allahun.
- 3) Mësimi i shkencave të tij dhe thirrja për të. k Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] ka thënë:

“خيركم من تعلم القرآن وعلمه

Më i miri prej jush është ai që mëson Kur'anin dhe ua mëson të tjerëve!”¹⁰

- 4) Të kuptuarit e domethënieve të tij, meditimi dhe marrja mësim nga këshillat e tij.
- 5) Kureshtja dhe interesimi për ta mësuar përmendësh. E, nëse nuk ke vullnet për ta mësuar, atëherë ki kujdes të jesh prej atyre për të cilët thotë Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*]:

“إن الذي ليس في جوفه شيء من القرآن كالبيت الخرب

Ai që në barkun (brendësinë) e tij nuk ka diç nga Kur'ani, i është sikur shtëpia e rrënuar!”¹¹

¹⁰ Transmeton Buhariu. 4739.

¹¹ Hadithin e transmeton Timridhiu në Sunen, 2135, dhe përkundër asaj që disa thonë se është hasen, Albani thotë se ka dyshime në të. Një grup madje e kanë cilësuar të

- 6) Veprimi sipas tij, përvetësimi i moralit dhe i etikës së tij, gjykim sipas tij në punët e fesë dhe jetës së përditshme. Veprimi sipas tij është çelës i suksesit dhe garanci për shpëtim në këtë dhe botën tjetër. Ibn Kethiri duke shpjeguar ajetin 30 nga kaptina el-Furkan:

وَقَالَ الرَّسُولُ يَرْبِّ إِنَّ قَوْمِي اتَّخَذُوا هَذَا الْقُرْآنَ مَهْجُورًا ﴿٣٠﴾

E i dërguari tha: "O Zot im, vërtet populli im e konsideroi këtë Kur'an si (diç) të hedhur!"

...ka thënë: "Braktisja e Kur'anit nënkupton braktisja e vërtetimit të tij, braktisja e meditimit dhe të kuptuarit të tij, mosveprimi sipas tij dhe mospërfillja e urdhëresave dhe ndalesave të tij, braktisja e tij duke anuar ka gjëra tjera si poezi, këngë apo epsh...".¹²

Kjo ishte një përmbledhje e obligimeve tona karshi Librit të Allahut, Kur'anit Famëlartë!¹³

dobët. Askalani, Ahmed ibn Alij ibn Haxher, *Hidajeturr rruvani ila tahrixhi ehadithil mesabih evl mishkah ve meahu tahrixhul Albani lil Mishkah*, f. 2077.

¹² Ibn Kethir; Ebul Fida Ismail el-Kureshijj ed-Dimeshkijj, *Tefsiru-l-Kur'ani-l-adhim*, 2/197.

¹³ Për më shumë shih: Kardavi, Jusuf, *Kejfe neteamel meal Kur'anil Adhim – fehmen ve tefsiren*, f.12-65.

3. RAPORTET E PEJGAMBERIT [alejhis salatu ves selam] DHE SELEFIT ME KUR'ANIN FISNIK

Për të qenë zemra e besimtarit e gjallë dhe për të rrahur bashkë me Kur'anin, konsideroj se një gjë që do të dikonte shumë pozitivisht në këtë drejtim është edhe përmendja e raporteve të Muhammedit [alejhis salatu ves selam], Sahabeve [Allahu qoftë i kënaqur me ta!] dhe gjeneratave vijuese me Kur'anin!

Imam Muslimi transmeton nga sahabiu i nderuar, Hudhejfeja [Allahu qoftë i kënaqur me të!] i cili rrëfen për vete:

“صليت مع رسول الله صلى الله عليه وسلم ذات ليلة، فافتتح البقرة، فقلت: يركع عند المائة. ثم مضى، فقلت: يصلي بها في ركعة؛ فمضى. ثم افتتح النساء فقرأها، ثم افتتح آل عمران فقرأها. يقرأ مترسلاً، إذا مرّ بآية فيها تسبيح سبح، وإذا مرّ بسؤال سأل، وإذا مرّ بتعوذ تعوذ..”

Një natë u fala me të Dërguarin e Allahut [alejhis salatu ves selam], i cili e filloi namazin me kaptinën el-Bekare. Lexoi gjatë ndërsa unë thashë se tek njëqindshi i parë bën rukunë! Por, vazhdoi derisa thashë se me të po e përfundon një rekat. Ai vazhdoi filloi ta lexonte kaptinën en-Nisa, pastaj Ali Imran. E lexonte me qetësi. Kur lexonte ndonjë ajet madhërimi, e madhëronte Allahun, kur lexonte ndonjë ajet të lypjes, i lypte Allahut (falje, mirësi), e kur lexonte ndonjë ajet të mbrojtjes, kërkonte mbrojtje tek Allahu (nga djalli i mallkuar)...”¹⁴

Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] e ftonte Ummetin në meditimin dhe studimin e Kur'anit. Kur u shpallën ajetet 190-191 nga kaptina Ali Imran:

إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَأَخْتِلَافِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ لَآيَاتٍ لِّأُولِي الْأَلْبَابِ ﴿١٩٠﴾ الَّذِينَ يَذْكُرُونَ اللَّهَ قِيَمًا وَقُعُودًا وَعَلَىٰ جُنُوبِهِمْ وَيَتَفَكَّرُونَ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ رَبَّنَا مَا خَلَقْتَ هَذَا بَطْلًا سُبْحَانَكَ فَقِنَا عَذَابَ النَّارِ ﴿١٩١﴾

¹⁴ Shih: Muslimi me sherh të Neveviut, 3/34.

Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt. 191. Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thënë): Zoti ynë, këtë nuk e krijoje kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit!"

...Pejgamberi [alejhis salatu ves selam], si rrëfen Ajsheja [Allahu qoftë i kënaqur me të!] u ngrit në një natë dhe tha: O Ajshe! Më lër ta adhuroj Zotin tim! Pasha Allahun! Unë e dua afërsinë tënde (qëndrimin me mua) por e dua edhe atë që ty të bën të gëzuar, - pastaj vazhdon Aisheja rrëfimin e thotë,- U ngrit, mori abdes dhe filloi të falej ndërsa nuk e ndali të qarit derisa iu lag prehri. Qau prapë aq shumë dhe nuk u ndal derisa iu lag edhe toka (vendi ku falej). Erdhi Bilalli të kërkonte leje për namaz (ta thërriste ezanin), por kur e pa në atë gjendje duke qarë, i tha: O i Dërguari i Allahut, po qan ndërsa Allahu të ka falur mëkatet e mëparshme dhe ato të mëvonshme?! A të mos jam rob falënderues -ia ktheu ndërsa shtoi më pas: Më janë shpallur dy ajete, mjerë për atë që i lexon e nuk i mediton!"¹⁵

Ibni Abbasi, ky sahabi i nderuar, ka thënë: "Të falësh dy rekate namaz me meditim është më mirë se të falësh tërë natën pa zemër (pa këtë përkushtim)." ¹⁶

Fudajl Ibn Ijjadi thoshte: "Kur'anin, në të vërtetë, është shpallur që të punohet sipas tij, kështu që njerëzit e kanë marrë leximin e tij si punë. E si punohet sipas tij? - e pyetën. Tha: Duke lejuar të lejuaren e tij, duke ndaluar të ndaluarën e tij si dhe duke qëndruar te çudirat e tij!" ¹⁷

Është vërtetuar se nga gjeneratat e para ka patur burra të cilët e kanë kaluar tërë natën duke medituar vetëm një ajet. Preokupimi i tyre nuk ka qenë vetëm hatmeja e Kur'anit, pra leximi i tërë Kur'anit, por meditimi dhe studimi. Muhammed Ibn Ka'b el-Kuredhij ka thënë: "Që të lexoj gjatë tërë natës vetëm kaptinën el-Zelzele ose el-Kariah, por duke i medituar, është më e dashur për mua se sa ta lexoj tërë Kur'anin duke nxituar."

¹⁵ Albani në Silsletu-s-sahihah, 1/147, thotë se hadithi është i mirë -xhejjid.

¹⁶ Abdullah ibn Mubarek e ka përmendur në Kitabu-z-zuhd, 1/97.

¹⁷ Për më shumë rreth gjendjes së selefite me Kur'anin, kthehu tek *El-burhan fi ulumi-l-Kur'an*, 1/450-454.

Temim ed-Dari e kishte kaluar tërë natën duke lexuar vetëm këtë ajet:

أَمْ حَسِبَ الَّذِينَ اجْتَرَحُوا السَّيِّئَاتِ أَنْ نَجْعَلَهُمْ كَالَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ سَوَاءً
مَحْيَاهُمْ وَمَمَاتِهِمْ سَاءَ مَا يَحْكُمُونَ ﴿٢١﴾

A menduan ata, të cilët vepruan në të këqija, se në jetën e tyre dhe në vdekjen e tyre do t'i bëjmë të barabartë me ata që besuan dhe bënë vepra të mira? Sa i shëmtuar është gjykimi i tyre?” (el-Xhathije, 21)

Seid Ibn Xhubejri e kaloi një natë të tërë duke përsëritur vetëm këtë ajet:

وَأَمْتَنُوا الْيَوْمَ أَيُّهَا الْمَجْرُمُونَ ﴿٥٩﴾

E tash, o ju kriminelë, ndahuni! “ (Jasin, 59)

Disa nga të parët thoshin se nuk konsiderojnë të shpërblehen nga Allahu nëse e lexojnë një ajet ndërsa nuk e kuptojnë atë. Sulejman Darani thoshte se ndonjëherë leximi i një ajeti i merrte katër ose pesë netë, dhe sikur unë të mos e ndalja meditimin në të, nuk do të mund të kaloja tek ajeti tjetër.

Njëri nga të parët - selefi – kishte kaluar plot gjashtë muaj në meditimin e kaptinës ‘Hud’.

Një njeri i mençur ka thënë: Unë çdo javë kryej një hatme, po kështu dhe për çdo muaj nga një, e edhe në vit një, vetëm se kam një hatme që për tridhjetë vjet ende nuk po mund ta mbaroj.

Pra, kjo flet për meditimin dhe studimin e Kur’anit. ¹⁸

¹⁸ Rumi, Fehd Abdurrahman, *Ittixhahat et-tefsir fil karni err-rrabië asher*, f.20-25.

II. DRITËZA NGA THËNIET E KOMENTUESVE RRETH VLERËS DHE MIRËSISË SË MEDITIMIT TË KUR'ANIT FISNIK

1. KOMENTUESIT KLASIKË

1.1. Imam Zemahsheri, në koment të ajetit:

كَتَبَ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبْرَكٌ لِيَدَّبُرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿١٠٠﴾

(Ky është) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend." (Sad, 29),

...thotë: "...meditimi i Kur'anit nënkupton të menduarit në të dhe të thelluarit në studimin e asaj që shpie tek njohja e shpjegimeve të sakta dhe domethënieve të mira të cilat meditohehen... Hasan -ibn Thabit- ka thënë: Këtë Kur'an e kanë lexuar robërit dhe fëmijët që nuk kanë dije për të: kanë mbajtur në mend shkronjat e tij ndërsa kanë shkelur normat e tij. Prej tyre ka që edhe betohet se ka lexuar tërë Kur'anin ndërsa nuk ka lëshuar as edhe një shkronjë pa e shqiptuar, e mjerisht e ka lëshuar tërë Kur'anin (nuk ka vepruar sipas tij në asgjë). Nuk shihen gjurmët e Kur'anit as në moralin dhe as në veprat e tij. Ai, duke mbajtur përmendësh shkronjat e tij dhe duke shkelur normat e tij, nuk është as i mençur dhe as mbrojtës i Kur'anit. Allahu mos i shumoftë të tillët! O Zoti im! Na bë prej dijetarëve që meditojnë dhe kurrsesi prej lexuesve mendjemëdhenj!"¹⁹

1.2. Imam Fahrudin Rrazii, në koment të ajetit që cituam më parë (ajeti 29 nga kaptina Sad), ka thënë: "...e, nëse nuk e mediton, nuk thellohet dhe nuk bekohet prej Allahut, atëherë ai nuk do të mund të mësojë këto urtësi dhe sekrete mahnitëse, të përmendura në këtë Kur'an Madhështor..."²⁰

1.3. Imam Kurtubiu, në koment të ajetit 21 nga kaptina el-Hashr:

¹⁹ Zemahsheri, Ebul Kasim Mahmud ibn Amr ibn Ahmed Xharullah, *El-Kesh-shaf*, 6-17.

²⁰ Razi, Muhammed Fahrudin, *Mefatihul gajb - Et-Tefsir el-kebir*, 13/137.

لَوْ أَنْزَلْنَا هَذَا الْقُرْآنَ عَلَىٰ جَبَلٍ لَّرَأَيْتَهُ خَاشِعًا مُّتَصَدِّعًا مِّنْ خَشْيَةِ اللَّهِ ۗ وَتِلْكَ الْأَمْثَلُ
 نَضْرِبُهَا لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ ﴿٨٢﴾

Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur'an mbi ndonjë kodër, do ta shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga All-llahu. Këta janë shembuj që ua shkoqisim njerëzve, që ata të mendojnë.“

...thotë: “Është nxitje për meditim dhe thellim në këshillat kur'anore. Është shpjegim se nuk ka arsytim në braktisjen e meditimit, për arsye se, sikur ky Kur'an tui drejtohej kodrave që më parë do t'u jepej arsyeja, do t'u nënshtroheshin këshillave të tij dhe do ta shihje se si, me gjithë fortësinë e saj dhe ngurtësinë e tyre, do të përuleshin dhe do të nënshtroheshin nga frika e Allahut, ndërsa ju o të nënshtruar me mrekullitë e tij, nuk shpresoni në premtimet e tij dhe nuk keni frikë kërcënimeve të tij.”²¹

Siç vërejmë nga shpjegimet e komentuesve klasikë, ata janë fokusuar në meditimin si çelës i sekreteve kur'anore. Ata, po kështu, aluduan se sikur të ngarkoheshin me këtë Kur'an edhe sendet e ngurta do t'i nënshtroheshin atij, ndërsa njeriu, me gjithë arsyen dhe logjikën, refuzon ta bëjë këtë gjë. Vërtet, kjo gjë është për të të habitur për të keq. Allahu ka thënë:

أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ ۚ وَلَوْ كَانَ مِنْ عِنْدِ غَيْرِ اللَّهِ لَوَجَدُوا فِيهِ اخْتِلَافًا كَثِيرًا ﴿٨٢﴾

A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej All-llahut, do të gjenin në te shumë kundërthënie.“ (en-Nisa, 82)

E, duke qenë se është prej Allahut, atëherë përputhshmëria e brendshme e tij është shumë e lartë.

²¹ Kurtubi, Ebu Abdullah Muhammed ibn Ahmed el-Ensari, *El-xhamiu li ahkamil Kur'an*, 18/44.

2. KOMENTUESIT BASHKËKOHORË

2.1. Prof.Sejjid Kutbi në koment të ajetit 24 nga kaptina Muhammed:

أَفَلَا يَتَذَبَّرُونَ الْقُرْآنَ أَمْ عَلَى قُلُوبٍ أَقْفَالُهَا ﴿٢٤﴾

A nuk e studiojnë me vëmendje Kur'anin? Por jo, ata janë zemra që kanë drynat e vet!"

..thotë: "...ata janë që vazhdojnë në sëmundjen dhe hipokrizinë e tyre derisa të largohen nga kjo gjë, në të cilën kanë hyrë ne fene e Allahut sipërfaqësisht ndërsa nuk kanë qenë te sinqertë me Allahun, nuk i janë bindur Atij. Ata janë që Allahu i ka mallkuar, i ka larguar dhe përzënë nga udhëzimi. Atyre Allahu ua ka bërë veshët e shurdhër dhe sytë e verbër. Ata nuk kanë humbur dëgjimin dhe shikimin. Atyre iu është tërheqë funksioni i këtyre ndjenjave. Ato sikur janë paralizuar. Për këtë edhe është bërë pyetja në formë mohuese: "**A nuk e studiojnë me vëmendje Kur'anin?**" ngase meditimi i Kur'anit heq perden, hap dritaret, hedh dritën, lëviz ndjenjat, mobilizon zemrën, pastron ndërgjegjen, krijon një jetë të shpirtit, me të cilin rrah, ndriçon dhe reflekton. "**Por jo, ata janë zemra që kanë drynat e vet!**" këta që hapin hendeqe ndërmjet tyre dhe Kur'anit, ndërmjet tyre dhe nurit. Mbyllja e zemrave të tyre është sikur mbyllja me dry, ku nuk depërton drita dhe as ajri." ²²

2.2. Tahir ibni Ashur, në koment të ajetit 82 nga kaptina en-Nisa:

أَفَلَا يَتَذَبَّرُونَ الْقُرْآنَ ۚ وَلَوْ كَانَ مِنْ عِنْدِ غَيْرِ اللَّهِ لَوَجَدُوا فِيهِ اخْتِلَافًا كَثِيرًا ﴿٨٢﴾

A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej All-llahut, do të gjenin në te shumë kundërthënie."

...thotë: "Domethënia e 'A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur'anin?' është a nuk thellohen në domethëniet e tij, dhe kjo mund të ketë njëren prej dy kuptimeve:

- 1) Të zhyten në botëkuptimet e hollësishme të ajeteve të tij dhe këtë në dritën e objektivave në të cilat ai drejtoi – udhëzoi muslimanët, pra të meditojnë hollësitë dhe detajet, dhe

²² Kutb, Sejjid, Fi dhilalil Kur'an, 6/451.

- 2) Të meditojnë Kur'anin si tërësi, me retorikën dhe stilin e ti, si Libër i shpallur nga Allahu dhe se kumtuesi i tij është njeri besnik.

Konteksti i këtij ajeti e favorizon mendimin e parë si të saktë, e që i bie se nëse ata e meditojnë Kur'anin dhe thellohen në udhëzimet e tij, do t kenë jetë të lumtur. E, meqë ata mbetën në gjendjen që ishin, pra fshehën kufirin ndërsa shfaqën Islamin, atëherë të dy rastet (domethëni) mund t'iu përshtaten atyre, vetëm se, për shkak të tipareve të tyre të përshkruara, domethënia e parë mbetet më shumë e lidhur me ta..."²³

2.3. Shejh Shenkiti, në koment të ajetit 29 nga kaptina Sad:

كَتَبَ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبْرَكٌ لِيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٩﴾

(Ky është) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend."

...thotë: "I Madhëruari në këtë ajet kur'anor po na tregon se e ka shpallur këtë Libër, duke madhëruar Vetën e Tij në shumës, se ai është Libër i bekuar ndërsa urtësi e zbritjes së tij, përveç tjerash, është dhe meditimi i fakteve të tij nga njerëzit, gjegjësisht kuptimi dhe zhytja ose thellimi në domethëni e tij në mënyrë që t'i kuptojnë llojet e udhëzimit, që të zotët e mendjes të marrin mësim, pra që të mençurit të këshillohen..."²⁴

Siç mund të vërehet nga komentet e këtyre mufessirëve bashkëkohorë, shkak pse jobesimtarët nuk udhëzohen është mosmeditimi i këtij Libri. Sejjid Kutbi shumë bukur aludoi në këtë kur tha: "...meditimi i Kur'anit heq perden, hap dritaret, hedh dritën, lëviz ndjenjat, mobilizon zemrën, pastron ndërgjegjen, krijon një jetë të shpirtit, me të cilin rrah, ndriçon dhe reflekton..."

Ndërsa Ibni Ashurin e gjetëm me dy mendime interesante përkitazi me meditimin:

- 1) Meditimin e Kur'anit hollësisht, dhe këtë nën hijen e objektivave në të cilat i drejtoi myslimanët. Pra, kemi të bëjmë me meditim të hollësishëm dhe te detajuar.
- 2) Meditimi i Kur'anit si tërësi si Libër i shpallur nga Allahu dhe se ai që e kumtoi ishte besnik dhe i sinqertë...

²³ Ibn Ashur; Muhammed Tahir, *et-Tahriru ve-t-tenvir*, 3/483.

²⁴ Shenkiti, Muhammed El-Emin ibn Muhammed el-Muhtar el-Xhekni, *Advaul bejan fi idahil Kur'ani bil Kur'an*, 7/9.

Kurse Shenkiti fokusohet në urtësinë e zbritjes së Kur'anit, e që është: "...gjegjësisht kuptimi dhe zhytja ose thellimi në domethëniet e tij në mënyrë që t'i kuptojnë llojet e udhëzimit..."

Si vërtetim për shpjegimet e komentuesve të cituar, ekzistojnë edhe një sërë ajetesh, disa prej të cilave do t'i përmendim:

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ إِذَا ذُكِرَ اللَّهُ وَجِلَّتْ قُلُوبُهُمْ وَإِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِمْ آيَاتُهُ زَادَتْهُمْ إِيمَانًا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ ﴿٢٠٠﴾

E, besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të të cilëve kur përmendet All-llahu u rrëqethen zemrat e tyre, të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi, dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre.” (el-Enfalë, 2)

قُلْ ءَامِنُوا بِهِ أَوْ لَا تُؤْمِنُوا إِنَّ الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ مِنْ قَبْلِهِ إِذَا يُتْلَىٰ عَلَيْهِمْ سَجِرُونَ لِالَّذِقَانِ سَجْدًا ﴿١٧٧﴾ وَيَقُولُونَ سُبْحٰنَ رَبِّنَا إِن كَان وَعْدُ رَبِّنَا لَمَفْعُولًا ﴿١٧٨﴾ وَسَجِرُونَ لِالَّذِقَانِ يَبْكُونَ وَيَزِيدُهُمْ خُشُوعًا ﴿١٧٩﴾

Thuaj: "I besuat ju atij ose nuk i besuat (atij nuk i bëhet dëm), e atyre që u është dhënë dijeni (nga librat e parë) para tij, kur u lexohet atyre, ata hedhen me fytyra (përdhe) duke i bërë sexhde". 108. Dhe thonë: "I lartësuar është Zoti ynë, premtimi i Zotit tonë është realizuar". 109. Dhe duke qarë hidhen me fytyra (kur dëgjojnë Kur'anin) dhe ai ua shton edhe më përruljen (ndaj All-llahut).“ (el-Isra, 107-109)

﴿١٧٧﴾ قُلْ يٰٓأَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَنْ تَخْشَعَ قُلُوبُهُمْ لِذِكْرِ اللَّهِ وَمَا نَزَلَ مِنَ الْحَقِّ وَلَا يَكُونُوا كَالَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ مِنْ قَبْلُ فَطَالَ عَلَيْهِمُ الْأَمَدُ فَقَسَتْ قُلُوبُهُمْ ۖ وَكَثِيرٌ مِّنْهُمْ فَسِقُونَ ﴿١٧٨﴾

A nuk është koha që zemrat e atyre që besuan të zbuten me këshillat e All-llahut dhe me atë të vërtetën që zbriti (me Kur'an), e të mos bëhen si ata, të cilëve u është dhënë libri më parë e zgjati koha dhe zemrat e tyre u shtangën e shumë prej tyre janë jashtë rrugës.” (el-Hadid, 16)

وَإِذَا سَمِعُوا مَا أُنزِلَ إِلَى الرَّسُولِ تَرَىٰ أَعْيُنُهُمْ تَفِيضُ مِنَ الدَّمْعِ مِمَّا عَرَفُوا مِنَ الْحَقِّ^ط
يَقُولُونَ رَبَّنَا ءَأَمَنَّا فَاكْتُبْنَا مَعَ الشَّاهِدِينَ ﴿٨٣﴾

Kur e dëgjojnë atë që i është zbritur të dërguarit (Kur'anin), prej syve të tyre rrjedhin lotë, ngase e kanë kuptuar të vërtetën dhe thonë: "Zoti ynë, ne kemi besuar, pra na regjistro ndër ata që dëshmojnë (ndër umetin e Muhammedit)." (el-Maide, 83)

Nga këto ajete fisnike kuptojmë se meditimi është një proces logjik dhe shpirtëror ²⁵. E kur mendja të ketë kuptuar sekretet e domethënieve të ajeteve kur'anore, atëherë ajo do të lëshojë rrezet e saj edhe tek trupi, në mënyrë që fizikisht dhe shpirtërisht besimtari të përjetojë madhësinë e Kur'anit. Për të përjetuar këtë ëmbëlsi kur'anore, gjithsesi se duhen përgatitur edhe ambientet. Respektivisht, bëjmë mirë që ta lexojmë Kur'anin gjatë natës atëherë kur njerëzit të kenë fjetur. Këtu qëndron sekreti i heroizmit, sakrificave, dijes dhe adhurimit të dijetarëve tanë nga gjeneratat e para. Ata e kanë provuar këtë dhe kanë jetuar me këtë ëmbëlsi kur'anore. Të këtillë kanë qenë Imam Gazaliu, autori i *Ihja-së*, Ibni Tejmije, autori i *Fetava-ve*, Ibnul Kajjimi, autori i *Zadul Mead-it* dhe *Medarixhus salikine*. Në këto libra mund të gjesh mësimë për përjetim të Kur'anit, për shkak se vetë këta autorë e kanë përjetuar atë andaj edhe e kanë shkruar më së miri.

²⁵ Buti, Muhammed Seid Ramadan, *Min revai-l-Kur'an – teemmulat ilmijeh ve edebijeh fi Kitabi-l-Lahi azze ve xhel-le*, f. 10-50.

III. NEVOJA E SJELLJES NDËRMEND TË MORALIT DHE ETIKËS GJATË MEDITIMIT

1. ETIKA SHPIRTËRORE DHE PSIKIKE E MEDITIMIT

Nuk më ka rënë të shoh ndonjërin nga dijetarët më parë të kenë bërë ndarje të këtilla të edukatës përkitazi me meditimin. Ata, e tëra që kanë bërë, është një përmbledhje e edukatës dhe e metodologjisë në një vend. Madje, disa nga këto parimet mund t'i gjesh tek njëri dhe jo tek tjetri. Kështu, ne, me lejen e Allahut, do të bëjmë një mbledhje dhe klasifikim të tyre tematik. Më konkretisht, do t'i referohem *Itkanit* të Sujutit, *Burhanit* të Zerkeshiut, *Ihja-së* të Gazaliut, *Fevaid-it* të Ibnul Kajjimit si dhe punimeve tjera të rëndësishme, rezymeja e të cilave do të ishte si vijon:

- 1) Besimi korrekt dhe zhveshja nga epshi.
- 2) Nijeti dhe qëllimi i mirë.
- 3) Edukata dhe morali i mirë.
- 4) Gjurmimi i saktësisë dhe vërtetësisë në tekstet e transmetuara.
- 5) Modestia de butësia.
- 6) Krenaria dhe shfaqja publikisht e së vërtetës.
- 7) Autoriteti, dinjiteti, durimi dhe ndërgjegjja.
- 8) Qëndrimi te çdo ajet dhe impresionimi prej tij.
- 9) Sinqeriteti gjatë leximit dhe sjellja në mendje madhështinë e Allahut Fuqiplotë.
- 10) Bindja se atë që e lexon nuk është nga fjalët e njerëzve.
- 11) Të mos merret Kur'ani si mjet për të realizuar qëllimet e dynjasë
- 12) Largimi nga mëkatet ngase ato humbin dritën e besimit nga zemra.
- 13) Kërkimi mbrojtje nga Allahu gjatë leximit (thënia eudhu bil-lah...) dhe largimi i cytjeve - bisedës së nefsit.
- 14) Ruajtja e duarve nga lëvizja e padobishme. Po kështu, ruajtja e shikimit, në mënyrë që në fokus të jetë vetëm Kur'ani.
- 15) Përkujdesja që leximi të jetë në kohët kur shfaqet mëshira e Allahut, si namazi, gjatë natës, sidomos në pjesën e tretë, pas namazit të sabahut, e kështu me radhë.
- 16) Përsëritja e ajeteve dhe të qarit sidomos nga ajetet ku përmenden ndëshkimi, skenat e Kiametit, trishtimi i llogarisë, etj²⁶.

²⁶ Shih: Zerkeshiu, Ebu Abdullah, *El burhan fi ulumil Kur'an*, 1/449-452; Sujuti, Ebu Abdurrahman, *El-itkan fi ulumil Kur'an*, 1/445; Gazali, Ebu Hamid, *Ihja ulumid-din*, 1/280-320.

- 17) Dituria e dhuntisë, e cila është si dhuratë për të gjithë ata që punojnë sipas asaj që e dinë. Krugë e realizimit të saj janë veprat e mira dhe asketizmi. Ka thënë Imam Zerkeshiu në el-Burhan: *“Dije se ai që ka bidat në zemrën e tij nuk mund të kuptojë domethëniet e shpalljes dhe as që i shfaqen atij urtësitë e saj. Po kështu, edhe ai që ka mendjemadhësi, epsh, dashuri për dynjanë, ngul këmbë në mëkate, nuk ka besim të vërtetuar apo është i dobët në besim, apo mbështet në mendimin e ndonjë komentuesi që nuk ka dituri...”*²⁷
- 18) Mbështetja në Allahun dhe kujdesi që të bësh prishësh veprat me syefaqësi apo vetëpëlqim.
- 19) Nënshtrimi komplet ndaj Allahut dhe përgjërimi tek Ai që ta frymëzojë për suksesin dhe të qëlluarën në kuptimin e ajeteve.
- 20) Asketizmi në dynja dhe dashuria për botën tjetër²⁸.
- 21) Serioziteti dhe realizmi gjatë meditimit.
- 22) Njohja e rrethanave historike të shpalljes së Kur’anit²⁹.
- 23) Studimi i ajeteve të besimit duke u munduar të nxirren reflektime, rezultate dhe analiza³⁰.
- 24) Vërtetimi i çështjes së *hakimijes* dhe *uluhijes* (se pushteti dhe adhurimi janë vetëm për Allahun) në mënyrë që të zënë vend në zemrat e njerëzve³¹.
- 25) Vetëbesimi dhe guximi në mendimet dhe qëndrimet e ndërtuara.
- 26) Përpjekja për të përjetuar shpalljen. Ndjesia kur mediton sikur je në Mekke ose Medinë në kohën kur janë shpallë ajetet³².
- 27) Vëzhgimi i lëvizjeve të Sahabeve dhe bashkëveprimit të tyre me Kur’anin në ambientin mekkas dhe medinas. Ose, meditimi në atë që Sejjid Kutbi do ta quante ‘Fenomeni i Kur’anit mekkas, aprovimi i besimi dhe ndalimi që ajo të klasifikohet tek gjërat dytësore’³³...Besimi është kriter vlerësimi derisa fitorja me

²⁷ Shih: Sujuti, Ebu Abdurrahman, *El-itkan fi ulumil Kur’an*, 1/445: *El-burhan fi nulumi-l-Kur’an*, 2/175/201; *El-muvafekat* të Shatibiut, 3/347-348.

²⁸ El-Akk, Halid Abdurrahman, *Usulu-t-tefsiri ve kavaiduhu*, f.80-83; 188; Zerkani, Muhammed Abdul Adhim, *Menahil el urfan fi ulumil Kur’an*, 1/250.

²⁹ Kutb, Sejjid, *Et-tasvirul fenijj lil-Kur’an*, f. 30-50; Kutb, Sejjid, *Fi dhilalil Kur’an*, 305-400.

³⁰ Zurzur, Muhammed Adnan, *Med’hal ila et-tefsir ve ulumihi*, f. 267.

³¹ Kutb, Sejjid, *Mukavvemat et-tesavvuril islamijj*, f. 41; 81.

³² Halidi, Salah Abdul Fettah, *Mefatih li-t-teamuul mea-l-Kur’an*, f. 59.

³³ Kutb, Sejjid, *Mealim fit tarik*, 21-22.

domethëniet më qenësore është fitorja e shpirtërores ndaj materiales...³⁴

- 28) Të kuptuarit se Islami përfshin çdo gjë dhe të gjitha poret e jetës.
- 29) Të perceptuarit e nevojës së madhe të njerëzimit për besimin. Sejjid Kutbi e përshkruan këtë nevojë kështu: *“Është uri e llojit të rrallë, uri për tek besimi me një fuqi më të madhe se njeriu, me një botë më të madhe se kjo që shihet dhe një fushë nga jeta e botës: uri për të harmonizuar tek njeriun ndërgjegjen me realitetin, uri për të harmonizuar njerëzinë e tij, e cila sundon me ndërgjegjen, dhe fenë, e cila sundon me jetën e tij, uri për të harmonizuar dinamikën individuale dhe atë kozmike rreth tij; uri për tek një Zot i vetëm, prej të Cilit, njëkohësisht, merr ligjin për zemrën e tij dhe ligjin për shoqërinë e tij...”*³⁵
- 30) Të kuptuarit e urtësisë që qëndron prapa kësaj urie dhe nevoje njerëzore për fenë, dhe e cila është: *“...program hyjnor i nxjerrë nga dija, në vend të padijes, nga përsosmëria, në vend të mangësive, nga fuqia, në vend të dobësisë, nga urtësia, në vend të epshit, i ngritur mbi themelin e nxjerrjes së njerëzve nga adhurimi i njerëzve në adhurimin e Zotit të njerëzve, që është Një dhe tjetër nuk ka...”*³⁶
- 31) Vështrimi integrativ në ajetet kur’anore.
- 32) Studimi i hollësishëm i ajeteve kur’anore që krahasojnë veprën me besimin ngase ato janë bazë në jetën e njeriut.³⁷
- 33) Ndarja e fesë nga shteti, ngase, siç thotë Sejjid Kutbi, *“nuk është natyrë e programit hyjnor që të përkufizohet vetëm në ndjenjat sentimentale, pastrimin e moralit dhe ritet fetare, apo në një fushë të ngushtë që tashmë po e quajmë ‘e drejta civile’ .”*³⁸
- 34) Dhënia përparësi fesë në çdo gjë dhe se ajo nuk mund të jetë e gjykuar apo e udhëhequr. Ajo është që gjykon dhe udhëheq përherë...³⁹
- 35) Që kriza dhe problemet e jetës së përditshme të mos kenë ndikim negativ në jetën tonë. ato nuk guxojnë të inspirojnë pesimizëm⁴⁰.

³⁴Ibid, 170-171.

³⁵Ibid. Shih faqet: 68-69; 101. Shih po kështu: Kutb, Sejjid, *Nahve muxhtemein islamijjin*, f. 29.

³⁶ Shih po kështu: Kutb, Sejjid, *Nahve muxhtemein islamijjin*, f. 5-13; Kutb, Sejjid, *Hasaisu et-tesavvuril islamijj*, f.22.

³⁷Kutb, Sejjid, *Hasaisu et-tesavvuril islamijj*, f. 182-183.

³⁸Kutb, Sejjid, *Fi dhilalil Kur’an*, 7/89-90; Kutb, Sejjid, *Mealim fit tarik*, f. 38-39.

³⁹Kutb, Sejjid, *El-mustakbel li hadhed din*, f. 93; Kutb, Sejjid, *Mukavvemat et-tesavvuril islamijj*, 84-107; 109; 132-134.

- Përkundrazi. Shoqëruesi i Kur'anit duhet ta ketë forcën shpirtërore që të tjerët nuk e kanë dhe prej tij duhet ta fitojë edhe fuqinë për të qëndruar gjatë në meditim. Sejjid Kutbi thoshte: *“Këtë bindje përfitojmë nga qëndrimi i gjatë me Kur'anin, nga shoqërimi i gjatë me përpjekjet njerëzore për të shpjeguar dhe sqaruar (të vërtetën), nga praktikat individuale për të shkruar për një periudhë të gjatë...”*⁴¹
- 36) Të kuptuarit e metodologjisë së Sahabeve në leximin dhe meditimin e Kur'anit. Ata e lexonin Kur'anin për ta praktikuar dhe jo vetëm sa për tu dëfryer me lexim. Thotë Sejjid Kutbi: *“Vërtetë, metodologjia e të lexuarit për të ekzekutuar - vepruar është ajo që ka nxjerrë gjeneratën e parë (të tillë, të papërsëritshëm, siç kanë qenë), ndërsa metodologjia e të lexuarit për studim dhe dëfrim është ajo që ka nxjerrë gjenerata pasuese.”*⁴²
- 37) Mos-ndikimi nga sistemet e ndryshme ideologjike dhe politike të vëna nga njeriu, si: komunizmi, demokracia, marksizmi, socializmi, kapitalizmi, sekularizmi, ateizmi, globalizmi, modernizmi, etj.
- 38) Të kuptuarit e ndikimit kishtar në rendin politik, ekonomik dhe shoqëror të botës, si dhe përpjekjet e tyre për ta deformuar imazhin islam. Po kështu, edhe zhytjen e tyre në mëkate, si pedofilia, orgjitë nëpër kisha, etj.
- 39) Të kuptuarit e metodave sioniste të çifutëve ekstremë për ta shuar identitetin islam dhe mësimet fetare islame në Palestinën e pushtuar si dhe çifutizimin e Kudsit të shenjtë.

⁴⁰Kutb, Sejjid, *El-mustakbel li hadhed din*, f. 116-117; Kutb, Sejjid, *Hasaisu et-tesavvuril islamiyy*, f. 87.

⁴¹Kutb, Sejjid, *Mukavvemat et-tesavvuril islamiyy*, f. 24-25; Kutb, Sejjid, *Hasaisu et-tesavvuril islamiyy*, f. 10.

⁴²Kutb, Sejjid, *Mealim fit tarik*, f. 19.

2. ETIKA SHPIRTËRORE DHE PARIMET MORALE SIPAS IMAM GAZALIUT

Imam Gazaliu ka pjesë shumë të bukura të thëna për çështjen për të cilën po flasim. Konsideroj se është shumë e rëndësishme të shkëpusim disa paragrafë duke dashur t'ia rikujtoj këtu lexuesit të nderuar se ato, mbase mund të duken si të përsëritura në shikim të parë, por nuk janë të tilla, ngase Imami ka mënyrën e vet unike në prezantimin, shpjegimin dhe lidhjen ndërmjet pjesëve të këtij sistemi.

Me këtë rast, do të doja të përmend se veprat e brendshme (edukata shpirtërore) e lexuesit të Kur'anit duhet të jetë një rregull ideor, moral dhe shpirtëror për medituesi e Kur'anit, po kështu. Imam Gazaliu thotë: Kapitulli III: Për veprat e brendshme të leximit, e që janë dhjetë: (1) Të kuptuarit e bazës dhe esencës- thelbit të të folurit; (2) respektimi – madhërimi i Tij; (3) prania shpirtërore; (4) meditimi; (5) të kuptuarit e mirë; (6) zhveshja nga pengesat e të kuptuarit; (7) veçimi; (8) të ndikuarit; (9) avancimi; (10) dhe modestia.

- 1) Të kuptuarit e madhësisë së të folurit. Është të Folur të Allahut. Është mirësi dhe butësi e madhe e Tij me robërit, ngase ka bërë që, ndonëse është aq madhështor dhe nuk ka fare nevojë për krijesat, të folurit e Tij ta zbres në nivelin që t'i bëjë njerëzit të kuptojnë.
- 2) Madhërimi i Folësit. Ikrime ibn Ebi Xhehlit i binte të fikët kur e hapte mus'hafin. Është të folurit e Zotit tim! Është të folurit e Zotit tim! –thoshte. Kur i shkante ndërmend Arshi, Kursijja, qiejt, toka, njerëzit dhe xhinët dhe gjithë çka ka ndërmjet tyre, dhe kur e dinte se Krijuesi, Mbizotëruesi dhe Furnizuesi i të gjitha këtyre është Një, dhe se të gjithë janë në dorën e Tij, ndërmjet mirësisë dhe mëshirës së Tij si dhe ndërmjet ndëshkimit dhe fuqisë së Tij; nëse dhuron, atëherë me mirësinë e Tij, e nëse ndëshkon, atëherë me drejtësinë e Tij...
- 3) Prania shpirtërore – përkushtimi dhe vigjilenca. Në koment të ajetit:

يٰٓيَحْيٰٓى خُذِ الْكِتٰبَ بِقُوَّةٍ وَّءَاتَيْنٰهُ الْحِكْمَ صَبِيًّا ﴿١٢﴾

O Jahja, merre librin me shumë kujdes, dhe ashtu Ne i dhamë atij urtësi kur ishte fëmijë. (Merjem, 12)

...është thënë: merre Librin me zell dhe seriozitet, gjë që nënkupton të përkushtohesh tërësisht gjatë leximit dhe të të mos shkojë mendja tek diç tjetër...

- 4) Meditimi. Meditimi qëndron pas pranisë dhe përkushtimit shpirtëror, për shkak se ndodhë që njeriu të mos mendojë për diç tjetër përveç Kur'anit por të mos meditojë ngase dëshiron ta dëgjojë

veten duke lexuar, etj. Ndërsa qëllimi i leximit është meditimi. Ka thënë Aliu [Allahu qoftë i kënaqur me të!]: “Nuk ka mirësi në adhurimin, në të cilin nuk ka të kuptuar, de as në leximi, në të cilin nuk ka të medituat!” E, nëse nuk mundet të meditojë vetëm se duke e përcjellë – përsëritur fjalinë, atëherë e ta bëjë, me përjashtim kur falet pas Imamit. Ebu Dherri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ka thënë: I Dërguari i Allahut u fal një natë me ne ndërsa përsërit këtë ajet:

إِنْ تُعَذِّبُهُمْ فَإِنَّهُمْ عِبَادُكَ وَإِنْ تَغْفِرَ لَهُمْ فَإِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿١١٨﴾

Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robër Tu, e nëse u falë atyre, Ti je i gjithëfuqishmi, i urti.“ (el-Maide, 118)

- 5) Të kuptuarit. Që nga secili ajet të ketë të qartë atë që i përshtatet kuptimisht atij. Kjo ngase Kur’ani në gjirin e vet përmban cilësi të Allahut të Madhëruar dhe vepra të Tij, përmban po kështu edhe rrëfime për profetët, rrëfime për femohuesit dhe përgënjeshtuesit, përmban urdhëresa dhe ndalesa, flet për Xhennetin dhe Xhehennemin, kështu që le t’i meditoj këto gjëra në mënyrë që t’i zbulohen domethëniet e fshehura, të cilat nuk i zbulohen vetëm se atyre të bekuarve për sukses. Ka thënë Ibni Mes’udi: “Kush e do diturinë e të parëve dhe të mbaramëve, le ta shpërthen Kur’anin!” Për këtë arsye, kush do që lexon ajetet në vijim:

أَفَرَأَيْتُمْ مَا كَحَرْتُونَ ﴿٦٣﴾

A nuk e shihni atë që e mbillni?“ (el-Vakiah, 63)

أَفَرَأَيْتُمْ مَا تُمْنُونَ ﴿٥٨﴾

A më tregoni për farën që e derdhni, “ (el-Vakiah, 58)

أَفَرَأَيْتُمُ الْمَاءَ الَّذِي تَشْرَبُونَ ﴿٦٨﴾

A e shihni ujin që po e pini?“ (el-Vakiah, 68)

أَفَرَأَيْتُمُ النَّارَ الَّتِي تُورُونَ ﴿٧١﴾

A e keni parë zjarrin që ju e ndizni?“ (el-Vakiah, 71)

...duhet që shikimin të mos e përkufizojë vetëm në ujë, zjarr, vendmbjellje dhe spermë, por se si kjo e fundit është një pikë uji, e cila më pas shndërrohet në copë mishi, për t’u formuar më pas në gjymtyrë trupore, e për të marrë më pastaj edhe karaktere të ndryshme, disa të vrazhdë, të butë, etj.

Ndërsa sa i përket gjendjes së mohuesve, le të jetë të kuptuarit e tij në shërbim të frikës nga hidhërimi dhe ndëshkimi i Allahut. Le të merr mësim se si nuk duhet ndjekur rrugën e shkatërraqëve sepse fundi i saj është dëshpërim.

Nga përshkrimi i Xhennetit dhe Xhehennemit le të kuptojë se nuk mund të përthekohet ajo që kuptohet ngase nuk ka fund. E, ai që nuk kupton atë që gjendet në Kur'an, qoftë edhe në nivelet më të ulëta, atëherë ai është pjesë e ajetit të 16 nga kaptina Muhammed:

وَمِنْهُمْ مَنْ يَسْتَمِعُ إِلَيْكَ حَتَّىٰ إِذَا خَرَجُوا مِنْ عِنْدِكَ قَالُوا لِلَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ مَاذَا قَالَ

ءَانفَاءً أُولَٰئِكَ الَّذِينَ طَبَعَ اللَّهُ عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ وَاتَّبَعُوا أَهْوَاءَهُمْ ﴿١٦﴾

Prej tyre ka asish që vijnë të dëgjojnë ty, por kur largohen prej teje, u drejtohen atyre që kanë dije u thonë: "Çka tha ai (Muhammedi) më parë?" Ata janë zemrat e të cilëve i ka vulosur All-llahu e ata udhëhiqen pas dëshirave të veta."

Zaten, është thënë se *muridi* nuk mund të jetë *murid* derisa nuk gjen në Kur'an tërë atë që kërkon, nuk mëson për mangësinë sa herë që dijen e shton (pra, e kupton sa e gjerë është dija) dhe nuk mjafton me Allahun nga krijesat e Tij...

- 6) Largimi i pengesave të të kuptuarit. Shumë njerëz janë privuar nga kuptimi i domethënieve madhështore të Kur'anit për shkak të perdeve që djalli i mallkuar ka lëshuar mbi zemrat e tyre. Muhammedi [*alejhis salatu ves selam!*] ka thënë:

“لولا أن الشياطين يحومون على قلوب بني آدم لنظروا إلى الملكوت

Sikur djajtë të mos rrethonin zemrat e bijve të Ademit, ata do të shihnin edhe në pushtetin qiellor (melekutin)!”

Domethëniet e Kur'anit janë pjesë e melekutit dhe çdo gjë që shqisat nuk mund ta detektojnë dhe nuk mund të arrihet vetëm se me nurin e argumentit, është pjesë e melekutit. Gjërat që i vënë perde melekutit janë katër:

- a) Që fokusi gjatë leximit të jetë vetëm në nxjerrjen – shqiptimin e tingujve. Djalli krijon mëdyshje se nuk i kanë shqiptuar mirë andaj i sheh tek i kthehen një tingulli të vetëm disa herë. Për shkak të përqendrimit vetëm në shqiptimin e tingujve, njerëzit e kësaj kategorie privohen nga kuptimi i thellë i domethënieve të Kur'anit.
- b) Fanatizmi medh'hebor, që nuk e lë të dalë jashtë asaj që qëndron në drejtimin të cilin e pason.

c) Që të ketë ngulur këmbë në ndonjë mëkat të caktuar, të jetë mendjemadh apo të jetë pasues i epshit. Këto gjëra janë shkak për errësimin e zemrës. Është si të thuash pluhurosje e pasqyrës që pamundëson shikimin e pastër në të. E, sa herë që epshet të jenë më komplekse, atëherë mundësia që zemra të zbulojë domethëniet e Kur'anit pakësohet gjithnjë e më tepër. Ndërsa, sa herë që brengat e dynjasë janë më të pakta, atëherë mundësia që zemra të thellohet në zbulimin e këtyre domethënieve madhështore, është më e madhe. Zemra është sikur pasqyra ndërsa epshet sikur ndryshku – pluhuri ndërsa domethëniet e Kur'anit janë sikur fotot që shfaqen – duken në pasqyrë. E, përpjekja për ta ruajtur zemrën nga epshet është sikur pastrimi i pasqyrës. Për këtë shkak Muhammedi [*alejhis salatu ves selam!*] ka thënë:

“إذا عظمت أمتي الدينار والدرهم نزع منها هيبة الإسلام، وإذا تركوا الأمر بالمعروف والنهي عن المنكر حرموا بركة الوحي

Kur Ummeti im ta ketë stërmadhuar vlerën e dynjasë dhe parasë, atëherë frikërespekti i Islamit do të shkulet nga zemrat e tyre, ndërsa kur ta kenë braktisur urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja, atëherë do të privohen nga bereqeti i shpalljes.”

Fudajl ibn Ijjadi duke shpjeguar këtë hadith, thotë: Do të privohen nga kuptimi i Kur'anit. Allahu i Madhëruar ka kushtëzuar që për ta kuptuar Kur'anin duhet të jesh tip që pendohet. Allahu thotë:

تَبَصَّرَةٌ وَذِكْرَىٰ لِكُلِّ عَبْدٍ مُّنِيبٍ ﴿٨﴾

(I bëmë ashtu) Dëshmi të dukshme dhe përkujtuese për secilin njeri që ka drejtuar mendjen (te Zoti).“ (Kaf, 8)

هُوَ الَّذِي يُرِيكُمْ آيَاتِهِ وَيُنَزِّلُ لَكُمْ مِنَ السَّمَاءِ رِزْقًا وَمَا يَتَذَكَّرُ إِلَّا مَنْ

يُنِيبُ ﴿١٣﴾

Ai (All-llahu) është që po jua dëfton juve argumentet e veta, që ju sjell furnizim prej qiellit (shiun), por përveç atyre që janë të kthyer te Zoti, të tjerët nuk marrin mësim.” (Gafir, 13)

﴿ أَفَمَنْ يَعْلَمُ أَنَّمَا أُنزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ الْحَقُّ كَمَنْ هُوَ أَعْمَىٰ ۚ إِنَّمَا يَتَذَكَّرُ أُولُو

الْأَلْبَابِ ﴿١٥﴾

A është i njëjtë ai që e di se ajo që t'u shpall ty nga Zoti yt është e vërtetë, si ai që është i verbër? Vetëm njerëzit e arsyeshëm që kanë mendje të shëndoshë e kuptojnë të vërtetën.
“ (err-Rra’du, 19)

Ai që favorizon mashtrimet e dynjasë ndaj mirësive të ahiretit, ai nuk është prej të mençurve dhe atij, rrjedhimisht, nuk do t’i zbulohen sekretet e Kur’anit.

d) Që të ketë lexuar tefsire – koment sipërfaqësor të Kur’anit, kështu që të ndërtojë qëndrimet se nuk ka domethënie tjetër të ajeteve jashtë asaj që ka shpjeguar Ibni Ababsi, Muxhahidit, etj, dhe s kjo nuk bie ndesh me thënien e Aliut [Allahu qoftë i kënaqur me të!]: “Përveç, nëse Allahu i jep – dhuron robit të kuptuar për Kur’anin...”

7) Veçimi. Kjo nënkupton që çdo ajet ta mendosh sikur ka të bëjë me ty personalisht. Kur të lexojë ndonjë ajet njeriu për ndalimin ose lejimin, atëherë le të mendojë se ai është i ndaluar, respektivisht i urdhëruar për ta bërë atë punë. Po kështu kur të lexon ajete që premtojnë për shpërblime ose kërcënojnë për ndëshkim. Për këtë shkak Allahu ka thënë:

وَكُلًّا نَقُصُّ عَلَيْكَ مِنْ أَنْبَاءِ الرُّسُلِ مَا نُثَبِّتُ بِهِ فُؤَادَكَ ۚ وَجَاءَكَ فِي هَذِهِ الْحَقُّ

وَمَوْعِظَةٌ وَذِكْرَىٰ لِلْمُؤْمِنِينَ ﴿١٢٠﴾

Të gjitha këto që t'i rrëfyem ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që ta forcojnë zemrën tënde, dhe në to të ka ardhur e vërteta e këshilla, si dhe përkujtime për besimtarët.” (Hud, 120)

Kështu vepron edhe kur ligjërimi të jetë i përgjithshëm. Ai duhet ta interpretojë atë si individual; çfarë për të e çfarë për njerëzimin. Le të llogaritë sikur ai është që po përmendet në atë ajet. Allahu ka thënë:

وَأَوْحَىٰ إِلَيْنَا هَذَا الْقُرْآنَ لِأُنذِرْكُمْ بِهِ ۖ وَمَنْ بَلَغَ

... e mua më është shpallur ky Kur'an që me të t'ju tërheq vërejtjen juve dhe atij që i komunikohet (dhe të gjithë atyre që vijnë pas jush deri në ditën e kiametit)...” (el-En’amë, 19)

Muhammed ibn Ka’b el-Kuredhijj ka thënë: “Kujt i ka arritur Kur’anit, ai është sikur t’i ketë folur Allahu...”

Disa të urtë kanë thënë:

“Ky Kur’an është mesazhe që na kanë ardhur nga Allahu me premtimet e Tij, e të cilat në namaze i meditojmë, në vetmi i shqyrtojmë, në adhurime dhe sunnete të pasuara i zbatojmë.”

Malik Ibn Dinar thoshte:

“Çfarë ka mbjellë Kur’ani në zemrat tuaja, o ithtarët e Kur’anit? Kur’ani është pranvera e besimtarit ashtu siç shiu është pranverë e tokës...”

- 8) Ndikimi. Kjo nënkupton që zemra, varësisht nga përmbajtja e ajeteve, të ndikohet. Ai duhet të përjetojë sipas çdo domethënie një gjendje dhe ndjesi që reflekton në zemrën e tij, pikëllim, frikë apo shpresë qoftë. Sa më shumë që të jetë i ditur, përlja dhe frikërespekti ndaj Allahut do të jenë më të mëdha. Për këtë shkak Hasan Basriu ka thënë: “Pasha Allahun, nuk ka rob që ka gdhirë sot që e lexon Kur’anin dhe beson në të e që të mos i jetë shtuar pikëllimi dhe t’i jetë pakësuar gëzimi, t’i jetë shtuar të qarit dhe t’i jetë pakësuar të qeshurit, t’i jetë shtuar lodhja dhe angazhimi e t’i jenë pakësuar pushimi dhe mosangazhimi...”

Ndikimi i besimtarit nga leximi nënkupton që ai të jetë shndërruar në vet ajetin – vargun kur’anor. Mu për këtë shkak, Pejgamberi [alejhis salatu ves selam!] qau kur Ibni Mes’udi ia lexoi ajetin 41 të kaptinës en-Nisa:

فَكَيْفَ إِذَا جِئْنَا مِنْ كُلِّ أُمَّةٍ بِشَهِيدٍ وَجِئْنَا بِكَ عَلَىٰ هَٰؤُلَاءِ شَهِيدًا ﴿٤١﴾

Dhe si do të jetë gjendja e atyre (që nuk besuan), kur Ne do të sjellim dëshmitarë për çdo popull, e ty do të sjellim dëshmitarë mbi ata (që nuk të besuan)?”

Sytë e tij rridhnin lot për shkak se përjetimi i asaj gjendjeje kishte kapluar zemrën e tij plotësisht.

Ka patur njerëz që kur kanë dëgjuar ajetet kur’anore u ka rënë të fikët, bile edhe të atillë që nuk u kanë rezistuar fare dhe kanë vdekur. Për këtë gjë thuhet: Kur njeriu e lexon Kur’anin ndërsa nuk ka përvetësuar etikën dhe moralin e tij, e thërret Allahu: “Çfarë ke ti me të folurit Tim ndërsa më kundërshton?! Nëse nuk pendohesh, lëre të folurit Tim...”

Këtu qëndron arsyeja dhe shkaku pse Sahabet [Allahu qoftë i kënaqur me ta!] ishin më shumë të interesuar në praktikimin e Kur’anit se në nxënien e tij përmendësh.

Leximi i njëmendtë i Kur’anit nënkupton që gjuha, mendja dhe zemra të bashkëveprojnë: gjuha përmirëson shprehjet-shqiptimin, mendja botëkuptimet dhe domethëniet ndërsa zemra këshillohet dhe merr mësim. pra, gjuha lexon, mendja përkthen ndërsa zemra këshillohet.

- 9) Avancimi. Kjo nënkupton që të ngrihet dhe të avancojë gjatë leximit sikur ai nuk po e dëgjon veten por Allahun e Madhëruar. Leximi ka

tri shkallë: më e ulëta është që të paramendojë sikur po e lexon Kur'anin para Allahut dhe Ai po shikon në të dhe po e dëgjon. Kështu gjendja e tij sipas kësaj do të duhej të ishte lutje, përulje, përgjërime. Shkalla ose pozita e dytë është që me zemër të dëshmojë sikur Allahu po e sheh dhe po i flet me butësinë e Tij dhe po bisedon me begatitë dhe mirësinë e Tij. kjo gjendja nënkupton turpërimin, madhërimin, vëmendjen dhe të kuptuarit. Pozita e parë është kur anashkalon të gjitha dhe fokusohet vetëm në Folësin, sikur ai është zhytur thellë në shikimin e Folësit ndaj të tjerëve. Kjo është grada e *mukarrebineve* – njerëzve të dashur tek Allahu, ndërsa dy pozitat e para janë të djathtistëve derisa gjithë të tjerët janë neglizhentë. Për këtë shkak ka thënë një njeri i urtë:

“E lexoja Kur'anin, por nuk gjeja dot kënaqësi derisa nuk fillova ta lexoja sikur po e dëgjoja nga i Dërguari i Allahut duke ua lexuar shokëve të tij. pastaj avancova, u bëra sikur po e dëgjoja nga Xhibrili [alejhiselam] i cili ia lexonte Muhammedit [alejhis salatu ves selam!]. pastaj u ngrita në një pozitë tjetër, sikur po e dëgjoj nga vet Folësi. Vetëm tash arrita kënaqësinë dhe dëfrimin pa të cilat nuk mund të qëndroj dot...”

- 10) Modestia. Kjo nënkupton që njeriu të mos e shikojë veten si të spastruar nga mëkatet, si të lartësuar, si të zhveshur nga gabimet. Kur të lexojë ajetet e premtimit dhe lëvdimit për të devotshmit le të mos e klasifikojë veten në mesin e tyre, por le të shfaq një mallëngjim dhe dëshirë të madhe që të jetë prej tyre, ndryshe nga ajetet ku bëhet fjalë për mëkatarët dhe neglizhentët, që do të duhej ta interpretonte në vetën e parë për shkak të frikës dhe nxitimit për tu përmirësuar. Ka thënë Omeri [Allahu qoftë i kënaqur me të!]:
“O Allahu im! Unë të kërkoj falje për padrejtësinë time dhe përbuzjen time!” Thanë: Hajde padrejtësia në rregull, por mohimi-përbuzja, si?!
 Tha: A nuk e keni lexuar ajetin kur'anor:

إِنَّ الْإِنْسَانَ لَظَلُومٌ كَفَّارٌ ﴿٣٤﴾

...Vërtet, njeriu është i padrejtë dhe shumë përbuzës.” (Ibrahim, 34)
 Sigurisht, kjo gjendje nuk mund të arrihet pa një modesti kulmore dhe pa i vënë në shërbim në vend të duhur këto mbulesa. Më konkretisht, kur të lexojë ajetet e shpresës, dominon aspekti i sihariqimit dhe i zbulohet Xhenneti sikur po e sheh. E nëse dominon frika, atëherë atij i zbulohen imazhe të Xhehennemit thuajse është duke e parë atë. Kjo për shkak se të folurit e Allahut përmban aspekte të së lehtës dhe të së butës, të së vështirës dhe të së ashprës, të shpresës dhe të frikës, dhe kjo varësisht nga gjendja dhe nga

përshkrimet: prej tyre ka që kanë të bëjnë me mëshirën dhe butësinë,
por edhe me hakmarrjen dhe dënimin...⁴³

Meqenëse natyra e librit nuk më lejon të zgjerohem më shumë, unë mjaftoj
me kaq me shpresën të kam përmbledhur ajkën e shpjegimeve për
meditimin dhe edukatën përkatëse dhe këtë nëpërmjet shpjegimeve të
dijetarëve tanë të hershëm dhe të dijetarëve bashkëkohorë.

⁴³ Gazali, Ebu Hamid, *Ihjau ulumid-din*, 1/280.

PËRFUNDIM

Ja, me ndihmën e Allahut, falënderimi të Cilit i takon fillim e mbarim, erdhëm në përfundim të këtij punimi, temë bosht e të cilit ishte përkujtimi i disa parimeve edukativo morale për ata që duan t'i qasen meditimit të njëmendtë të Kur'anit.

Punimi vërtetoi faktin se meditimi si adhurim është braktisur dhe se shumë njerëz, duke përfshirë këtu edhe myslimanë, kanë krijuar bindje të gabuara karshi Islamit. Sqaruar se përmirësimi i këtyre koncepteve të gabuara nuk do të ndodhë vetëm se duke iu rikthyer Kur'anit, duke vërtetuar se jo vetëm dijetarët kanë të drejtë në këtë gjë, porse të gjithë ata që shfaqin interes, dyert e Kur'anit i kanë të hapura, me kusht që të ruhet konteksti i përgjithshëm i ajeteve si dhe lidhshmëria paraprake dhe vijuese.

Punimi ka vërtetuar po kështu se meditimi i përkryer do të arrihet nëse paraprakisht për detaje të tij ti rikthehemi jetës profetike, jetës së gjeneratave të para, sahabeve, tabiinëve, si dhe dijetarëve të dëshmuar në këtë fushë. Punimi, krahas kësaj, provon se mbërritja tek meditimi i suksesshëm bëhet dhe duke aplikuar disa norma dhe parime etike e shpirtërore, të rëndësishme për t'iu zbuluar medituesit domethëniet madhështore të ajeteve kur'anore, të vërtetat hyjnore dhe domethëniet e fshehta të tij, urtësitë hyjnore dhe sekretet shkencore që përmban, e kështu me radhë.

Studimi ka parashtruar edhe nevojën e zhveshjes nga disa gjëra që pengojnë besimtarin nga të kuptuarit e vërtetë të Kur'anit, si rastet kur lexuesi preokupohet me shqiptimin e shkronjave më shumë se sa me domethëniet, apo kur imiton me fanatizëm ndonjë fraksion a grup, apo kur ngul këmbë në ndonjë mëkat, si mendjemadhësia, etj., gjëra këto që për zemrën e tij janë sikur pluhuri mbi pasqyrë që pamundëson shfaqjen e së vërtetës.

Studimin e kam përmbyllur me disa prej këtyre parimeve, të përmendura nga Huxh-xhetul Islam Ebu Hamid el-Gazali [*Allahu e pastë mëshiruar!*]

Allahun e Madhëruar e lus ta ketë pranuar këtë mund si një vepër të sinqertë për Të dhe nga mirësia e së cilës në Ditën e Llogarisë nuk do të më privojë!

Përshëndetjet qofshin për të Dërguarin, Muhammed Mustafanë, familjen,
shokët dhe të gjithë pasuesit e tij!

Dr. Hajredin Hoxha

Brunei Darussalam, 2011

Bibliografia

1. Albani; Muhammed Nasiruddin, *es-Silsiletu-s-sahihah*, Mektebetul mearif, Rijad.
2. Askalani, Ahmed ibn Alijj ibn Haxher, *Hidajeturr rruvani ila tahrixhi ehadithil mesabih evl mishkah ve meahu tahrixhul Albani lil Mishkah*, recensues: Ali ibn Hasen ibn Abdul Hamid Halebijj, 1422, Daru Ibnil Kajjim, Demam.
3. Bekkar, Abdul Kerim, *Asruna vel ajshu fi zemanihi-s-sa'b*, 2004, Darul kalem, Damask.
4. Buti, Muhammed Seid Ramadan, *Min revai-l-Kur'an - teemmulat ilmijjeh ve edebijjeh fi Kitabi-l-Lahi azze ve xhel-le*, 1982, Mektebetul Farabi, Damask.
5. El-Akk, Halid Abdurrahman, *Usulu-t-tefsiri ve kavaiduhu*, 1986, Darun nefais, Liban.
6. Esfehani; el-Husejn in Muhammed ibn el-Mufeddal, *Mufredat elfadhil Kur'an*, 1980, Darul kalem, Damask.
7. Gazali, Ebu Hamid, *Ihjau ulumid-din*, Darul melajin, Bejrut.
8. Gazali, Muhammed, *Kejfe neteamel meal Kur'an*, 1991, Virxhinia, USA.
9. Halidi, Salah Abdul Fettah, *Fi Dhilalil Kur'an fil mizan*, 1986, Darul menareh.
10. Halidi, Salah Abdul Fettah, *Tarifu-d-darisine bimenahixhi-l-mufessirine*, 2008, Darul kalem, Damask.
11. Ibn Ashur; Muhammed Tahir, *et-Tahriru ve-t-tenvir*, editimi 2, 1999, Darul fikr, Bejrut.
12. Ibn el-Kajjim; Muhammad ibn Ebu Bekr ibn Ejjub ibn Xheuzijjeh Ebu Abdullah, *Et-tefsir el-kajjim*, përmbledhur nga: Muhammed Uvejs Nadavi, recensuar nga Muhammed Hamid, libraria digjitale El-mektebetu-sh-shamileh, editimi 2, 2006, Medinë.
13. Ibn el-Kajjim; Muhammad ibn Ebu Bekr ibn Ejjub ibn Xheuzijjeh Ebu Abdullah, *el-Fevaid*, editimi 2, Daru Vehbe, Kajro.
14. Ibn Kethir; Ebul Fida Ismail el-Kureshijj ed-Dimeshkijj, *Tefsiru-l-Kur'ani-l-adhim*, 1983, Darul kalem, Damask.
15. Ibn Mendhur; Muhammed ibn Mukrim in Mendhur el-Ifrikijj el-Misrijj, *Lisanul arab*, editimi 1, Daru sadir, Bejrut.

16. Ibn Tejmije; Ahmed el-Harrani, *Mukaddimetun fi usuli-t-tefsir*, editimi 2, 1982, Darul hadith, Bejrut.
17. Kardavi, Jusuf, *El-Hasais el-ammeh li-l-Islam*, 1997, Muessesetu-rrrisale, Bejrut.
18. Kardavi, Jusuf, *Kejfe neteamel meal Kur'anil Adhim – femen ve tefsiren*, 1999, Darush shuruk, Kajro.
19. Kurtubi, Ebu Abdullah Muhammed ibn Ahmed el-Ensari, *El-xhamiu li ahkamil Kur'an*, Darul kitabil arabijj, Bejrut.
20. Kutb, Sejjid, *El-mustakbel li hadhed din*, 1988, ISAMT, shtypshkronja Fejsal.
21. Kutb, Sejjid, *Et-tasvirul fenijj lil-Kur'an*, Darush shuruk.
22. Kutb, Sejjid, *Fi dhilalil Kur'an*, 1985, Darush shuruk, Kajro.
23. Kutb, Sejjid, *Hadhed din*, 1999, Darush shuruk.
24. Kutb, Sejjid, *Hasaisu et-tesavvuril islamijj*, 1983, Darush shuruk, Bejrut.
25. Kutb, Sejjid, *Mealim fit tarik*, 1980, Darush shuruk, Bejrut.
26. Kutb, Sejjid, *Mukavvemat et-tesavvuril islamijj*, 1983, Darush shuruk, Bejrut.
27. Kutb, Sejjid, *Nahve muxhtemein islamijjin*, 1988, Darush shuruk.
28. Lahim, Halid ibn Abdul Kerim, *Mefatihul tedebburil Kur'an ven-nexhahi fil hajah*, 2004, Rijad.
29. Mejdani, Abdurrahman Hasen Habenkeh, *Kavaidu-t-tedebburil emthel li kitabil-lahi azze ve xhel-le*, 1989, Darul kalem, Damask.
30. Merzuni, Abdullah ibn Mubarek, *Kitabu-z-Zuhd*, Darul kutub el-ilmijeh.
31. Neveviu, Jahja ibn Sheref, *Et-tibjan fi arabi hameletil Kur'an*, 1996, Daru Ibni Hazm.
32. Razi, Muhammed Fahrudin, *Mefatihul gajb – Et-Tefsirl el-kebir*, 2000, Darul fikr, Bejrut.
33. Rumi, Fehd Abdurrahman, *Buhuth fi suli-t-Tefsir ve menahixhi*, 1413, Mektebetu Teube, Rijad.
34. Rumi, Fehd Abdurrahman, *Dirasat fi ulumil Kur'anil Kerim*, 1009, Univeristet Mbreti Suud, Rijad.
35. Rumi, Fehd Abdurrahman, *Itixhahat et-tefsir fil karni err-rabië asher*, 1986, Mektebetu-rrushd, Rijad.

36. Sahihu Muslim bi sherhi en-Nevevijj, 2000, Darul kalem, Damask.
37. Sahihul Buhari bi sherhi Ibni Haxher el - Askalani, 1998, Darul melajiin, Bejrut.
38. Senidi, Selman ibn Omer, Tedebburul Kur'an, 2001, revista El-bejan.
39. Sujuti, Ebu Abdurrahman, *El-itkan fi ulumil Kur'an*, 2000, Darul beshair, Bejrut.
40. Suneni i Tirmidhiut, recensues: Besh-shar Avad Maruf, 1996, Darul garbil islamijj.
41. Shenkiti, Muhammed El-Emin ibn Muhammed el-Muhtar el-Xhekni, *Advaul bejan fi idahil Kur'ani bil Kur'an*, 1995, Darul fikr, Bejrut.
42. Taberi, Ebu Xhafer Muhammed Ibn Xherir, *Xhamiul bejani an te'vili ajil Kur'ani*, 2006, Darul melajiin, Bejrut.
43. Tajjar, Musaid ibn Sulejman, *Mefhum et tefsir ve-t-te'vil vel istinbat vet tedebbur vel mufessir*, forumi ehull hadith, 2010.
44. Zemahsheriu, Ebul Kasim Mahmud ibn Amr ibn Ahmed Xharullah, *El-Kesh-shaf*, Daru Ibn Hazm, Rijad.
45. Zerkani, Muhammed Abdul Adhim, *Menahil el urfan fi ulumil Kur'an*, 1990, Darul Beshir, Bejrut.
46. Zerkeshiu, Ebu Abdullah, *El burhan fi ulumil Kur'an*, 2004, Mektebetu Vehbe, Xhidde.
47. Zurzur, Muhammed Adnan, *Med'hal ila et-tefsir ve ulumihi*, 1995, Darul kalem, Damask.